

**RELACION**  
**PËR**  
**DRAFTIN E METODOLOGJISË SË MASËS DHE TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT TË**  
**VEPRAVE TË MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT NË SISTEMIN E**  
**ADMINISTRIMIT KOLEKTIV**

**AKRONIME**

<b>AAK</b>	Agjenci e Administrimit Kolektiv
<b>ALBAUTOR</b>	Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Krijuesve në Fushën Muzikore dhe Audiovizive
<b>AKDIE</b>	Agjencia e Administrimit Kolektiv të të drejtave të interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve të veprave
<b>FABER COLLECTIVE PHONOGRAM</b>	Agjencia e Administrimit Kolektiv të mbrojtjes së prodhuesve të fonogrameve
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>DDA</b>	Drejtoria e të Drejtës së Autorit
<b>KKDA</b>	Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit
<b>LDA</b>	Ligji i të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to nr. 35/2016, i ndryshuar.
<b>MEKI</b>	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
<b>OSHMA</b>	Ofrues shërbimi mediatik audioviziv
<b>PBB</b>	Prodhim i Brendshëm Bruto
<b>Sporteli unik</b>	Sporteli unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve

## TABELA E PËRMBAJTJES

KONSIDERATAT DHE PËRFSHIRJA E PALËVE	5
REFERENCAT, MBLEDHJA E INFORMACIONIT DHE PALËT PËR HARTIMIN E METODOLOGJISË	7
MBLEDHJA E INFORMACIONIT NGA PALËT KRYESORE TË INTERESIT	7
KUADRI LIGJOR	9
ANALIZA E METODOLOGJISË AKTUALE SIPAS LDA	11
SHEMBUJ NDËRKOMBËTARË TË ZBATIMIT TË TARIFAVE	18
1. Bullgari (1 BGN = 0,5 EUR)	18
2. Greqia	20
3. Rumania	21
4. Kroacia	25
KRAHASIMI - METODOLOGJIA AKTUALE ME SHTETE TË TJERA	31
4. Tabela nr. 1 Tarifa për komunikimin në publik në strukturat akomoduese	31
5. <i>Tabela nr. 2</i> Tarifa për komunikimin në publik të veprës së mbrojtur në vendet ku konsumohet ushqime dhe/ose piqe.	33
6. <i>Tabela nr. 3</i> Tarifa për komunikimin në publik në Radio të veprës së mbrojtur.	34
7. <i>Tabela nr. 4</i> Tarifa për komunikimin në publik në Televizion të veprës së mbrojtur.	35
8. <i>Tabela nr. 5</i> Tarifa për performancat live të veprës së mbrojtur. Në metodologjinë në R.SH nuk egzistojnë tarifa për performanca të drejtpërdrejta të koncerteve.	38
9. TARIFAT E PROPOZUARA NGA AAK-TË NË SHQIPËRI	39
TË DHËNA MAKROEKONOMIKE DHE TREGUESË ANALITIKË	40
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	51
PËRKUFIZIME	52
KONTRIBUTI I INDUSTRIVE TË BAZUARA NË TË DREJTAT E AUTORIT	53
BAZA LIGJORE DHE TË DHËNAT E PËRDORURA PËR METODOLOGJINË	55
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE	56
ANALIZË E LIGJIT PËR TARIFAT	57
TARIFAT E REJA, PROPOZUAR NGA SPORTELI UNIK DHE A.A.K.	62
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR NË RADIO	65
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK NË TELEVISION TË VEPRËS SË MBROJTUR	67
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK	70
NË STRUKTURAT AKOMODUESE ( <i>SUBJEKTE PËRDORUESE - HOTEL/ MOTEL / NJËSI AKOMODUESE E TË TJERA TË NGJASHME</i> ) TË VEPRËS SË MBROJTUR	70
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR	72
NË VENDE KU KONSUMOHEN USHQIME DHE/OSE PIJE	72
TARIFA PËR KOMUNIKIMIN NË PUBLIK TË VEPRËS SË MBROJTUR	74
NË NJËSI TREGTARE DHE MJEDISE TË TJERA BIZNESI	74

AKTIVITETE BIZNESI TË TJERA

75

KU KOMUNIKOHEN NË PUBLIK VEPRAT E MBROJTURA

75

## **HYRJE**

Hapi i parë në procesin e zhvillimit të metodologjisë së pronësisë artistike i ndërmarrë ishte një studim bazë për të konstatuar statusin aktual të performimit të metodologjisë që është zbatuar deri më sot nga organizata e të drejtës autoriale, në mënyrë që të identifikoheshin zonat ku sistemi metodologjik ishte shtrirë për të kuptuar edhe ndërhyrjet e mundshme nëpërmjet metodologjisë së rinovuar.

Po ashtu u realizua edhe vlerësimi i të gjitha akteve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi (praktikat më të mira) për hartimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit<sup>1</sup>.

Në draft metodologji përfshihet përmbledhja e kujdesshme e një identifikimi të gjerë të punës së kryer nga Sporteli unik dhe organizatat e mbrojtjes së të drejtës së autorit duke analizuar edhe të dhëna të performimit të tyre me përdoruesit, për të evidentuar për efekte të një metodologjie tarifash sa më pranë natyrës së kostos së administrimit të të drejtës së autorit, por edhe për një për afrim me praktikatat e mira të vendeve që kanë ngjashmëri me Shqipërinë (Bullgari, Greqi, Maqedoni e Veriut, Kroaci)

Qëllimi i punës së kryer është fokusuar edhe në një analizim të pikave të forta dhe të dobëta të metodologjisë aktuale të tarifave, me synimin për të mos përsëritur problematika që kanë dalë gjatë zbatimit të saj në një për qasje sipas kuadrit ligjor.

Në analizën e kryer është shkëmbyer informacion në lidhje me propozimet e përdoruesve të të drejtës së autorit dhe AAK-ve, me qëllimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe për reflektim të kërkesave në zbatim të kuadrit rregullator ligjor dhe nënligjor.

Pas takimeve të kryera me gjithë grupet kryesore të përdoruesve të të drejtës autoriale për produktet e autorëve sipas LDA.

Tarifat e përdorimit të veprës apo të drejtave të autorit, janë të rëndësishme për shkak se këto tarifa shpërndahen më pas tek mbajtësit e të drejtave. Për miratimin e tarifave të shpërblimit për përdorimin e të drejtave të autorit përcaktohet vlera/tarifa dhe metodologjia për t'u paguar nga çdo subjekt përdorues kundrejt AAK-së, për përdorimin e veprës/ve të autorit që ato administrojnë.

Këto tarifa vendosen me anë të një marrëveshje gjithëpërfshirëse të lidhur ndërmjet AAK-së dhe përfaqësuesve të shoqatës së përdoruesve ose, nëse kjo nuk është e mundur me vendim të KKDA-së.

### **I. OBJEKTI DHE QËLLIMI**

Draft metodologjia e masës dhe tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv (në vijim Metodologjia), ka për qëllim të promovojë dhe mbrojtë vlerat e të drejtës së autorit për të gjitha veprat e mbrojtura të përcaktuara në kuadrin ligjor të të drejtës së autorit si dhe të përcaktojë domosdoshmërinë e administrimit të përshtatshëm të

---

<sup>1</sup> <https://meki.gov.al/e-drejta-e-autorit/>

tërësisë së krijimit dhe/ose marrjes së rezultateve intelektuale të punës njerëzore dhe përdorimin efektiv të tyre duke synuar pajtueshmërinë me ligjin.

Objektivi i kësaj metodologjie është të stimulojë zhvillimin kulturor shkencor dhe si rrjedhim edhe ekonomik duke vendosur ekuilibrin e duhur midis interesave të mbajtësve të të drejtave të pronësisë intelektuale, interesave të përdoruesve dhe forcimin e sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale.

Ndryshimet e propozuara në metodologjinë e re kanë për qëllim të sigurojnë që ofruesit e shërbimeve dhe mallrave të përmbushin kërkesat e ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to (në vijim LDA), nëpërmjet rritjes në vazhdimësi të pajtueshmërisë në zbatimin e detyrimeve për pagimin e tarifave të përcaktuara si një shpërblim i autorëve për të drejtat e autorit.

Mbrojtja e autorëve të veprave të mbrojtura është një nga çështjet që synohet të përmirësohet nga ndryshimet e propozuara.

Kjo metodologji ka si qëllim edhe reduktimin e informalitetit, duke parashikuar që të zbatohet përmes bashkëpunimit me institucionet vendore dhe qendrore në përmbushjen e qëllimit.

Ndryshimet janë orientuar drejt lehtësimit të atyre tarifave që janë kontestuar si të pazbatueshme deri më sot nga gjithë operatorët dhe përdoruesit e veprave të autorëve të mbrojtur, si dhe zgjerimin e bazës së përdoruesve që duhet të paguajnë koston e përdorimit të veprave të mbrojtura sipas ligjit për të drejtën e autorit.

Ndryshimet e propozuara synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të zbatimit të ligjit përgjatë gjithë vitit dhe me shtrirje në të gjithë territorin e vendit, duke ofruar alternativa të bazuara edhe në propozimet e bëra nga grupet e interesit për qëllime të një përmbushje me bazë gjithëpërfshirëse dhe me kosto sa më të ulët gjatë llogaritjes dhe pagesës së tarifave sipas metodologjisë.

Në prezantimin e metodologjisë së masës dhe tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv nga përpunimi i informacioneve në disponim, si dhe atyre që janë mbledhur nga ekspertët, operatorët dhe përdoruesit e veprave të autorëve të kategorive të ndryshme vihet në dukje se të drejtat e autorit kanë qenë objekt i zbatimit praktik për më shumë se dy dekada.

Një sërë studimesh dhe analizash kërkimore janë kryer nga eksperti ndërkombëtar dhe ai kombëtar me qëllimin që në këtë metodologji të paraqiten si dinamikat ekonomike, po ashtu edhe ritmi i zhvillimeve të tyre.

## **KONSIDERATAT DHE PËRFSHIRJA E PALËVE**

Në caktimin e metodologjisë së tarifave u morën parasysh:

- a) të ardhurat që mund të sigurohen si rezultat i përdorimit të veprës ose objektit të të drejtave të lidhura;
- b) numri i publikut, të cilit i vihen në dispozicion veprat ose objektet e të drejtave të lidhura;
- c) rëndësia e përdorimit të veprave dhe objekteve të të drejtave të lidhura për veprimtaritë përkatëse të përdoruesve;
- ç) raporti i përdorimit midis veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, të mbrojtura dhe jo të mbrojtura;

d) krahasueshmëria e tarifave të propozuara me tarifatat e agjencive homologe të administrimit kolektiv në vende të tjera, veçanërisht me ato vende, të cilat kanë standard të përafërt zhvillimi ekonomik-social me Republikën e Shqipërisë.

dh) tarifatat e zbatuara për ritransmetimin kabllor pasqyrojnë, gjithashtu, numrin e përdoruesve familjarë që janë të lidhur në sistemet kabllore dhe natyrën e programeve të ritransmetuara.

Në përlllogaritjen e tarifave u mbajt parasysh edhe burimi i të ardhurave në formatin e subvencionit, abonimit dhe sponsorizimit, e përshkallëzuar, në masë më të ulët, në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga subvencionet për mbulimin e kostove operative, në masë më të rritur, në rastin e të ardhurave nga shërbimet e abonimit dhe në masa më të larta, në rastin e të ardhurave të marra nga reklamuesit dhe sponsorët tregtarë.

Agjencitë e Administrimit Kolektiv për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me to, përfaqësuesit e bizneseve përdoruese të veprave të autorëve me mendimet e tyre me gojë dhe shkrim ishin një vlerë kontribuese në hartimin e metodologjisë së re.

*Shqetësimet e përmbledhura të AAK-ve:*

- Përcaktime tarifore bazuar në të ardhurat bruto pa përjashtime;
- Është e vështirë të mblidhen të dhëna për përdorimin, si të ardhurat, si dhe të dhëna për vendndodhjen e përdoruesve, numrin e vizitorëve, numrin e dhomave në hotele, zonën e restoranteve dhe elementë të tjerë të rëndësishëm për llogaritjen e tarifës;
- Çështja e përjashtimit për punët dhe shfaqjet e krijuara me kontratë pune;
- Përcaktimi i zonave të biznesit, duke përfshirë zonat turistike, sipas pozicioneve të hartës së tyre për tarifim më të qartë dhe më të saktë;

*Qëllimi kryesor i përbashkët* midis palëve të interesit është të identifikohen çështjet në metodologjinë aktuale për ta harmonizuar atë me metodologjitë e vendeve të rajonit dhe të BE-së për një qasje më praktike dhe moderne.

Çështjet kryesore që u parashtruan nga palët paraqiten si vijon:

Eksperti ndërkombëtar u shpreh se çështjet kryesore që duhet të mbahen parasysh për hartimin e metodologjisë së re janë:

- Kërkesë për përkufizimin dhe ndryshimin e të ardhurave bruto dhe përjashtimet.
- Ndryshime në lidhje me tarifimin për të gjitha të drejtat e autorëve dhe të drejtat e tjera të lidhura me to për të gjitha veprat.
- Standartizimin e ligjit për të drejtën e autorit në përputhje me vendet më të zhvilluara dhe që janë pjesë e BE-së.

Ndërkohë nga AAK-të pjesëmarrëse në këtë proces draftimi bazuar mbi konsultime paraprake, u kërkua sa vijon:

- Përcaktimi i qartë i tarifimit për përdorimin e të drejtave të autorit dhe të ardhurave bruto në bazë të deklaratimit të saktë për sipërfaqen, numrin e dhomave etj, nga restorantet, baret, hotelet, si biznes i madh ose i vogël.
- Të mirë përcaktohen përjashtimet në lidhje me përdorimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.
- Mënyra se si do të trajtohet përdorimi i veprës kur vet autori është i punësuar dhe mbart një kontratë punësimi.

- Përcaktimin e zonave të bizneseve duke përfshirë zonat turistike, sipas pozicionimit në hartë për një tarifim më të qartë dhe të saktë.

## **REFERENCAT, MBLEDHJA E INFORMACIONIT DHE PALËT PËR HARTIMIN E METODOLOGJISË**

Baza ligjore për hartimin e metodologjisë, AAK-të dhe palët që veprojnë dhe zbatojnë këtë kuadër të plotësuar ligjor mund të shihen sipas linkut të MEKI<sup>2</sup>.

Me qëllimin që të përmenden edhe në mënyrë analitike disa nga referimet dhe aktorët kryesorë për këtë metodologji janë si në vijim:

- Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar
- Vendimi nr. 3 datë 4.8.2017 i KKDA “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv.”
- Vendimi nr. 2 datë 22.6.2018 i KKDA “Për disa ndryshime në vendimin nr. 3 datë 4.8.2017 ‘Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv.’”
- Vendimi nr. 350, datë 26.5.2022 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale, 2022 – 2025”;
- Relacioni i metodologjisë së miratuar;
- Të dhëna statistikore për PBB-në, taksapaguesit dhe bizneset në Shqipëri;
- Qëndrimet dhe propozimet e AAK-ve dhe përdoruesve kryesorë<sup>3</sup> dhe drafti i propozimit të përbashkët të AAK-ve të përgatitur nga Sporteli unik<sup>4</sup>.

## **MBLEDHJA E INFORMACIONIT NGA PALËT KRYESORE TË INTERESIT**

Informacioni i detajuar i mbledhur jepet këtu dhe mund të përmbliidhet si më poshtë:

---

<sup>2</sup> <https://kultura.gov.al/e-drejta-e-autorit/>

<sup>3</sup> ALBAUTOR, AKDIE, FMAA dhe FABER COLLECTIVE PHONOGRAM, OSHMA (RTL), TringTV/Vizion Plus, TCH, TV Klan, Club FM Radio, Vodafone OTT/IPTV, ONE Albania, BRC, BTSH, ATA, BTSH

<sup>4</sup> Në nenin 138 të LDA-së rregullohen dispozitat për një "one stop shop" për mbledhjen e tarifave (S.U.A.D.A.- Sporteli unik për administrimin e të drejtës së autorit) që synon të ofrojë një shërbim të efektshëm dhe efektiv për organizatat të ndryshme të menaxhimit kolektiv në Shqipëri. Ky sportel është i regjistruar si një organizatë jofitimprurëse dhe përfshin përfaqësues nga të gjitha organizatat e licencuara të menaxhimit kolektiv. Çdo AAK ka një anëtar në organin më të lartë vendimmarrës të një shërbimi me një ndalesë, duke siguruar përfaqësim të gjerë. AAK-ve u kërkohet të ndajnë bazat e të dhënave të anëtarësimit të tyre dhe informacione të tjera të nevojshme me një ndalesë për të lehtësuar mbledhjen e shpërblimeve.

Funksionimi dhe veprimtaria e one stop shop miratohen nga ministri përgjegjës për të drejtat e autorit. Të ardhurat e mbledhura shpërndahen ndërmjet AAK-ve që përfaqësojnë mbajtës të ndryshëm të të drejtave: 40% për mbajtësit e të drejtave të autorit, 30% për interpretuesit dhe 30% për prodhuesit, duke përfshirë botuesit dhe prodhuesit e fonogrameve.

Takimi i parë u zhvillua më 8 prill në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Morën pjesë zyrtarë të DDA, Eksperti kombëtar, Ekspertja ndërkombëtare, përfaqësues nga Sporteli unik dhe AAK-të, ALBAUTOR, AKDIE, dhe FABER COLLECTIVE PHONOGRAM.

AAK-të parashtruan si çështje kryesore përkufizimet e paqarta të tarifave për përdorimin e të drejtave të autorit dhe të ardhurave bruto në bazë të deklaramit të saktë për sipërfaqen, numrin e dhomave etj, nga 'restorantet', 'bare', 'hotelet', si biznes i madh ose i vogël. Ata diskutuan gjithashtu për mënyrën si do të trajtohet përdorimi i veprës kur autori është i punësuar dhe ka një kontratë punësimi. Si dhe sugjeruan përcaktimin e zonave të biznesit duke përfshirë zonat turistike, sipas pozicionimit në hartë, për tarifim më të qartë dhe të saktë.

DDA duke marrë shkas nga fakti që problematikat e evidentuara nga zbatimi i metodologjisë aktuale ende nuk kanë gjetur zgjidhje është e rëndësishme që të marin përgjigje në lidhje me çështjet që lidhen me:

Nëse llogaritja e të ardhurave nga AAK-të duhet të bëhet mbi të dhëna publike apo jo;

Duhet diskutuar midis palëve, kategoritë të cilat nuk janë të përfshira në metodologjinë aktuale, koncertet, transmetimet e proceseve sportive;

Argumentet në lidhje me heqjen e përjashtimeve;

Përshtatjen me vendet e rajonit dhe me vendet e BE-së, ku pushteti ka ndërhyrë për të garantuar mbledhjen e të ardhurave për të drejtat e autorit. Një praktikë e këtyre vendeve është përfshirja në një faturë të detyrueshme për të gjithë përdoruesit. Por sipas eksperiencave të mëparshme të vendit tonë kjo metodë nuk gjen zbatim.

Takimi i dytë më 9 prill u fokusua në komentet e përdoruesve në lidhje me përcaktimin e tarifave.

Të pranishmit përfshinin përfaqësues nga OSHMA, shpërndarës kabllor OTT dhe IPTV dhe shoqata e bareve dhe restoranteve, shoqata e bashkimit tregtar shqiptar, ACREM-balfin group si dhe shoqata albanian tourism association. Transmetuesit kundërshtuan rritjen e tarifave dhe mbështetën përjashtimet e të ardhurave bruto. Një nga kërkesat më të rëndësishme ishte paraqitja sa më transparente e shpërndarjes së të ardhurave të AAK-ve.

Ata sollën në vëmendje faktin që egzistojnë kontrata midis shumicës së autorëve dhe OSHMA-ve dhe pagesa bëhet në mënyrë direkte. Operatorët kabllorë, IPTV dhe OTT i bënë jehonë shqetësimeve për konkurrencën e pandershme nga ofruesit e paligjshëm.

Ofruesit e internetit të cilët ofrojnë shërbime në paketë e cila përbëhet nga internet,televizion dhe telefon, kanë probleme në llogaritjen e shumës që duhet të paguajnë për Sportelin unik,

Një shqetësim i përgjithshëm ishte dhe transmetimi në mënyrë pirate.

Dokumentet mbi situatat makroekonomike janë siguruar nga eksperti kombëtar, duke krahasuar të dhënat nga Bullgaria, Greqia, Maqedonia e Veriut dhe Rumania me Shqipërinë. Krahasimi tregoi se tarifat nga këto vende mund të përdoren si pikë referimi për Shqipërinë.

Sporteli unik ofroi të dhëna për të ardhurat totale, duke nxjerrë në pah se 83% e të hyrave të mbledhura ka ardhur nga shërbimet e transmetimit. Ata gjithashtu dhanë një llogaritje tarife për Vodafone, duke treguar të ardhura të konsiderueshme nga shërbimet kabllorë/IPTV/OTT.

Një dokument mbi stacionet radiofonike në Shqipëri detajonte numrin dhe llojet e radiostacioneve, ku 9% e shqiptarëve dëgjojnë radio çdo ditë.



ALBAUTOR dha një dokument mbi qëndrimin e tyre ndaj propozimit të tarifës së re, duke theksuar nevojën e të ardhurave bruto si bazë për tarifën pa përjashtime. Ata theksuan mospërputhjet në metodologjinë aktuale dhe kërkuan një rishikim për të pasqyruar përdorimin aktual të veprave të mbrojtura. Ata propozuan një tarifë të bazuar në përqindje prej të paktën 1.3% të të ardhurave bruto, me mundësi rritjeje vjetore.

Ata sugjeruan gjithashtu që tarifën për ngjarjet të bazohen në kostot ose çmimet e biletave dhe zbritjet e rekomanduara për pagesat në kohë, duke përjashtuar ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive dhe operatorët kabllorë.

Së fundi, ALBAUTOR siguroi një dokument mbi shpërndarjen e honorareve për telenovela, seriale dhe filma artistikë, duke treguar një skemë shpërndarjeje prej 40% për të drejtat e autorit, 30% për të drejtat e interpretuesve dhe 30% për producentët, botuesit dhe fonogramin. të drejtat e prodhuesve. Vetëm të drejtat e muzikës duhet t'i paguhet Sportelit unik për këto punime, me një skemë specifike shpërndarjeje ndërmjet AAK-së që do të përfaqësojë prodhuesit e audiovizualit dhe AAK-së që do të përfaqësojë muzikën, licencuar aktualisht ALBAUTOR.

## **KUADRI LIGJOR – LIGJI PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TO**

Në nenin 3 të ligjit për të drejtën e autorit, paraqitet një analizë e detajuar e kuadrit ligjor, e cila mund të përmbledhet si më poshtë:

Ligji Shqiptar nr. 35/2016 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta (LDA), i ndryshuar ofron një kuadër gjithëpërfshirës për mbrojtjen dhe administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Ligji përcakton të drejtat ekonomike të autorëve, interpretuesve dhe prodhuesve, duke specifikuar të drejtat ekskluzive dhe shpërblimet e tyre të përbashkëta. Administrimi kolektiv i këtyre të drejtave është i rregulluar, duke siguruar shpërndarje të drejtë dhe kontroll të shpërblimeve. Ligji mandaton administrimin kolektiv për transmetimin, ritransmetimin dhe kopjimin privat, duke supozuar përfaqësim për të gjithë mbajtësit e të drejtave.

LDA përcakton shpërblimet dhe tarifën në kontekste të ndryshme, duke theksuar qëndrueshmërinë dhe drejtësinë. Ai përshkruan kriteret për vendosjen e tarifave, duke marrë parasysh të ardhurat, madhësinë e audiencës dhe kostot.

Rregullat procedurale sigurojnë përcaktim të ligjshëm, të drejtë dhe transparent të tarifave, duke përfshirë palët e interesuara dhe duke lejuar marrëveshje ose ndërhyrje gjithëpërfshirëse nga Këshilli Kombëtar i të Drejtave të Autorit (KKDA) kur është e nevojshme.

Kriteret për përcaktimin e tarifave përfshijnë të ardhurat e mundshme nga përdorimi i veprave, madhësia e audiencës, kostot, rëndësia për aktivitetet e përdoruesve dhe krahasimet e tarifave ndërkombëtare. Zbatohen kriteret të ndryshme bazuar në llojin e përdorimit, si transmetimet ose koncertet, dhe mënyra e llogaritjes së tarifave mund të ndryshojë nga përqindjet e të ardhurave në shumën të përgjithshme.

LDA siguron që procedura dhe kriteret të përputhen me standardet e Bashkimit Evropian, duke theksuar transparencën, përfshirjen e palëve të interesuara, barazinë dhe rishikimin e shpeshtë të

tarifave për shkak të përputhjes me kushtet aktuale të tregut. Ai gjithashtu përfshin dispozita për një "one-stop-shop", Sporteli unik për të thjeshtuar mbledhjen e shpërblimeve për agjenci të ndryshme të administrimit kolektiv, duke siguruar shpërndarje efikase midis mbajtësve të të drejtave. Ky sistem promovon një qasje të strukturuar, transparente dhe të barabartë për administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me to në Shqipëri.

#### *Praktikat aktuale kombëtare – Vendimet e Këshillit Kombëtar të së Drejtës së Autorit*

Deri më tani, praktikat lokale janë përpiluar në këtë moment në dy Vendime të Këshillit Kombëtar të së Drejtës së Autorit. Ato janë analizuar në detaje këtu nën I.4. dhe I.5. Do të ishte me rëndësi të madhe të merret në konsideratë kjo analizë e detajuar sepse ajo jep perspektivë nga LDA dhe shpjegon pse përjashtime të veçanta nga të ardhurat bruto që shërbejnë si bazë për llogaritjen e përqindjes për tarifën për transmetim nuk janë në përputhje me LDA.

*Përmbledhja e konstatimeve të ekspertit:* Këshilli Kombëtar i së Drejtës së Autorit (KKDA) nxori Vendimin nr. 3, datë 4.8.2017, miraton metodologjinë dhe masën e tarifave për veprat e mbrojtura dhe çështje të tjera.

Vendimi përshkruan se çfarë përbën të ardhura bruto për përdoruesit dhe përjashtimet e specifikuar, si të ardhurat nga aktivitetet e palidhura me këto përdorime, reklamat e brendshme, sponsorizimet dhe investimet. Megjithatë, shumë nga këto përjashtime nuk përputhen me kriteret e përcaktuara nga LDA.

Për shembull, LDA kërkon që të ardhurat nga reklamat dhe sponsorizimet të përfshihen në të ardhurat bruto, në kundërshtim me përjashtimet e renditura në Vendimin e KKDA-së. Për më tepër, përjashtimet e bazuara në të ardhurat për punët e mbrojtura të krijuara gjatë punësimit ose të ardhurat nga shitjet e programeve të veta nuk mbështeten nga LDA, pasi të gjitha këto të ardhura duhet t'i nënshtrohen administrimit kolektiv.

Vendimi parashikonte gjithashtu tarifa të shprehura në shumën e përgjithshme për përdorime në mjedise jo thelbësore, si hotele dhe restorante, sipas kriterëve të përcaktuara nga LDA. Qasja e përgjithshme ndaj përjashtimeve të të ardhurave në Vendimin e KKDA-së nuk është në përputhje me kërkesat e LDA.

Në vendimin nr. 2 datë 22.6.2018, KKDA zgjeroi listën e përjashtimeve nga të ardhurat bruto për llogaritjen e tarifave.

Këto përjashtime, të sugjeruara nga ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive, përfshijnë të ardhura nga burime të ndryshme si prodhime të porositura, transmetime të ngjarjeve sportive dhe ngjarje të paguara për shikim.

Shumë nga këto përjashtime janë të ngjashme me ato të Vendimit të mëparshëm.

Në mënyrë të veçantë, përjashtimi i të ardhurave nga reklamat gjatë ngjarjeve sportive ose prodhimeve të porositura nuk është i justifikueshëm sipas LDA-së, i cili urdhëron që të gjitha të ardhurat që lidhen me përdorimin e veprave të mbrojtura të përfshihen në llogaritjet e të ardhurave bruto.

#### *Tarifa e propozuar nga AAK-të*

Sipas LDA-së, duhet të ndiqet metodologjia për caktimin e tarifave për përdoruesit nga neni 149 i LDA-së. Domethënë, kur përdorimi i objektit të mbrojtur nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose relaksues (si objektet e akomodimit, vendet e ekspozitës, mjetet e

transportit dhe objektet specifike hoteliere), shumën e shpërblimit përcaktohet si një shumë e përgjithshme e përhershme ose përdorim i rastit (neni 149 paragrafi 5 i LDA).

Nga ana tjetër, sipas nenit 149 paragrafi 1 i LDA-së, përcakton se nëse përdorimi i objektit të mbrojtur është thelbësor për veprimtarinë e një përdoruesi dhe kur veprimtaria e tyre varet nga ky përdorim, si në rastet e transmetimeve, koncerteve, ose përdorime të tjera të objektit të të drejtës së autorit kundrejt pagesës, masa e shpërblimit do të llogaritet në parim si përqindje e të ardhurave ose fitimit nga ky përdorim.

Prandaj, propozimet e AAK-ve duhet të pasqyrojnë rregullimet ligjore të LDA-së. Kjo do të thotë se metodologjia e propozuar për transmetuesit kombëtarë dhe të tjerë, d.m.th. radiot dhe televizionet dhe televizionet kabllorë duhet të llogaritet në përqindje.

E njëjta gjë duhet të zbatohet në rastet e koncerteve, festivaleve dhe ngjarjeve të ngjashme kulturore. Nga ana tjetër, kur muzika përdoret në bare, restorante, njësi tregtare, hotele dhe akomodime të ngjashme, të ardhurat për përdorime të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to duhet të llogariten si shumën e përgjithshme. Këto parime duhet të pasqyrohen në tarifë.

## **ANALIZA E METODOLOGJISË AKTUALE SIPAS LDA**

### *Tarifat e shprehura si përqindje e të ardhurave*

Mund të vërehet se pjesa më e madhe e të ardhurave që kanë të bëjnë me të ardhurat në bazë të përqindjes së aplikuar sipas këtij vendimit të KKDA nuk janë në përputhje me kriteret e përcaktuara me LDA.

Kur bëhet fjalë për përlogaritjen e tarifës në përqindje të të ardhurave, në nenin 149, paragrafi 1, LDA-ja shprehet: *“Nëse përdorimi i objektit të mbrojtur është thelbësor për veprimtarinë e një përdoruesi dhe kur veprimtaria e tyre varet nga ky përdorim, si p.sh. Në rastet e transmetimeve, koncerteve, valleve ose përdorime të tjera të objektit kundrejt pagesës, masa e shpërblimit do të llogaritet në parim si përqindje e të ardhurave ose fitimit nga ky përdorim.”*

Sipas vendimit të KKDA-së, nga përqindja e të ardhurave mbulojnë këto përdorime: transmetimet radiotelevizive, ritransmetimi kabllor, IPTV, OTT dhe platformat digjitale. Kjo është në përputhje me përcaktimet ligjore të LDA në lidhje me metodologjinë e të ardhurave, sepse të gjitha këto përdorime janë thelbësore për aktivitetin e përdoruesit.

Nga ana tjetër, në llogaritjen e të ardhurave të përdoruesit, metodologjia është e rregulluar edhe në LDA por nuk përfshin përjashtime nga të ardhurat e rregulluara në Vendimin e KKDA-së. Për shembull, LDA thekson se kriteret e mëposhtme duhet të merren parasysh gjatë llogaritjes së tarifës (pjesë veçanërisht të rëndësishme nënvizohen nga eksperti):

- Të ardhurat që mund të krijohen si rezultat i përdorimit të veprës ose objektit të të drejtave të përafërta;
- Numri i publikut të cilit i vihen në dispozicion veprat ose objektet e të drejtave të lidhura me to;

- Kur të ardhurat nuk pasqyrojnë natyrën e përdorimit të veprave ose të objekteve të të drejtave të përafërta, tarifën llogariten në bazë të kostove të bëra për përdorimin e tyre ose në bazë të ndikimit që ato kanë në shfrytëzimin normal nga mbajtësit e të drejtave;
- Rëndësia e përdorimit të veprave dhe objekteve të të drejtave të përafërta për veprimtaritë përkatëse të përdoruesve;
- Raporti i përdorimit ndërmjet veprave të mbrojtura dhe të pambrojtura ose objekteve të të drejtave të përafërta;
- Krahasueshmërinë e tarifave të propozuara me tarifën e AAK-ve në vende të tjera, veçanërisht ato vende me standard të krahasueshëm zhvillimi social-ekonomik me Republikën e Shqipërisë.
- Tarifën e aplikuar për ritransmetimin kabllor pasqyrojnë gjithashtu numrin e përdoruesve familjarë të lidhur me sistemet kabllorë dhe natyrën e programeve të ritransmetuara.
- Në llogaritjen e tarifave do të merret parasysh burimi i të ardhurave në formën e subvencionit, abonimit dhe sponsorizimit. Ai do të shkallëzohet në një masë më të vogël në rastin e të ardhurave që rrjedhin nga subvencionet për të mbuluar kostot operative. Ai do të shkallëzohet në një masë më të madhe në rastin e të ardhurave nga shërbimet e abonimit. Ai do të shkallëzohet në masën më të madhe në rastin e të ardhurave të marra nga reklamuesit dhe sponsorët komercialë.

Përrjashtimet e listuara nga të ardhurat bruto të parashikuara në Vendimin e KKDA-së do të analizohen brenda kriterëve dhe metodologjisë në lidhje me dispozitat e LDA-së.

Përrjashtimi i të ardhurave të përrshkuara si "a) të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të transmetuesve, si shitja e mallrave dhe produkteve; mund të përrjashtohet nëse nuk i referohet përrmbajtjes së mbrojtur. Përr shembull, nëse përrdoruesi kryen edhe aktivitete të tjera biznesi si shitja e librave, fletët e muzikës, regjistrimet nga arkivat e tij ose shitja e mallrave të tjera të ngjashme ose të ndryshme.

Fjala "produkte" këtu nuk duhet të interpretohet në asnjë mënyrë si produkte që lidhen me përrmbajtjen. Përr shembull, shitja e veprave audiovizuale të prodhuara në shtëpi ose shitja e përrmbajtjeve të tjera.

Vendimi i KKDA-së përrjashton nga të ardhurat "b) të ardhurat nga reklamat e produkteve të vetë OSHMA-ve; Ky përrjashtim nuk është i qartë dhe të gjitha kriteret e paqarta duhet të shmangen. Tarifën duhet të jenë të qarta, të thjeshta dhe të drejtpërrdrejta.

Produkti i një transmetuesi (OSHMA) mund të jetë gjithashtu përrmbajtje e transmetuar e krijuar duke përrdorur muzikën; prandaj, të ardhurat nga reklamimi i një përrmbajtjeje të tillë duhet të merren si bazë për llogaritjen e përrqindjes.

Duket se ky përrjashtim synon të zbrësë nga të ardhurat të ardhurat nga reklamat që i komunikohen publikut gjatë emisioneve të transmetuara ose ndërrmjet emisioneve të transmetuara. Kjo nuk mund të përrjashtohet nga të ardhurat.

Çdo e ardhur që rrjedh nga pagesat e palëve të treta për transmetuesin për komunikimin me publikun e reklamave në programet e transmetuesit duhet të përrfshihet në të ardhurat bruto që shërbejnë si bazë për llogaritjen e tarifave.

Gjithashtu, "c) të ardhurat e siguruara nga përrdorimi i veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënies së punës; nuk duhet të përrjashtohen nga të ardhurat që shërbejnë si bazë për llogaritjen e përrqindjes së tarifës. Gjegjësisht, nuk mund të supozohet se punonjësit e një

transmetuesi "tashmë janë paguar për krijimin e përmbajtjes së mbrojtur përmes pagave të tyre", siç thonë përdoruesit.

Konkretisht, sipas nenit 69 të LDA-së<sup>5</sup>, punëdhënësi fiton të drejtat ekskluzive pronësore për një periudhë 3 vjeçare nga data e dorëzimit të veprës tek punëdhënësi, për përdorim në lidhje me aktivitetet e tij të rregullta. Asnjë e drejtë tjetër e autorit apo e drejtë e lidhur nuk transferohet.

Përkundrazi, nëse të drejtat e fituara nga punëdhënësi duhet të zgjaten, duhet të lidhet një kontratë e re e veçantë (neni 69 paragrafi 5 i LDA). Të gjitha kontratat për të drejtën e autorit duhet të jenë me shkrim (neni 48 paragrafi 2 i LDA). Nuk ka asgjë të rregulluar në LDA në lidhje me pagën e autorit/performuesit-punonjësit.

Këtu duhet përsëritur se komunikimi me publikun, duke përfshirë transmetimin dhe ritransmetimin (ritransmetimin kabllor) të veprave muzikore, shfaqjeve dhe fonogrameve do të ushtrohen detyrimisht kolektivisht (shih nenin 131 paragrafët 1 a) deri në c) të LDA), që do të thotë se nuk lejohet administrimi individual i të drejtave.

Ideja e administrimit kolektiv të detyrueshëm në thelb është se nuk lejohet administrimi individual. Në këtë rast, kur vepra ose performanca krijohet me kontratë pune, zbatohet edhe administrimi kolektiv i detyrueshëm. Prandaj, nuk mund të supozohet sipas nenit 69 paragrafi 1 i LDA-së se shpërblimi për transmetim, ritransmetim dhe komunikim tjetër për publikun do të rregullohet përmes pagës pasi që paga jepet në bazë individuale të kontratës individuale.

Edhe nëse të drejtat janë me punëdhënësin (por vetëm për 3 vjet), shpërblimi për një përdorim të tillë duhet të ushtrohet përmes administrimit kolektiv të detyrueshëm. Nëse punëdhënësi ka fituar të drejtën për të marrë shpërblimin për një përdorim të tillë, kjo duhet të përcaktohet shprehimisht në kontratën e punës dhe jo të supozohet nga neni 69 paragrafi 3 i LDA.

Për më tepër, këtu duhet theksuar se të drejtat i takojnë punëdhënësit sipas nenit 69 paragrafi 1 të LDA-së vetëm për tre vjet, ndërsa përjashtimi nga përcaktimi i të ardhurave që shërben si bazë për llogaritjen e tarifës në Vendimin e KKDA i referohet të gjitha punëve dhe çështjeve të tjera të krijuara sipas një kontrate pune. Kjo nuk është në përputhje me nenin 69 paragrafi 1 i LDA-së. Për më tepër, përdoruesi si transmetuesi dhe operatori kabllor ose përdorues i ngjashëm nuk është në gjendje të komunikojë të dhënat se cilat të ardhura krijohen përmes përdorimit të veprave dhe shfaqjeve të krijuara sipas një kontrate pune dhe që krijohen nga përdorimi i veprave të tjera të mbrojtura, performanca dhe fonograme.

Në total, kjo çon në përfundimin se përjashtimi i të ardhurave nga përdorimi i veprave dhe shfaqjeve të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënies së punës nga baza për llogaritjen e tarifës nuk është në përputhje me metodologjinë, kriteret dhe dispozitat e tjera të LDA-së.

Në rast se një transmetues ka fituar të drejta nga punonjësit e tij për të marrë shpërblimin nga agjencitë e administrimit kolektiv, kjo duhet të deklarohet me shkrim në kontratë sipas nenit 48 paragrafi 2 i LDA-së dhe jo i supozuar nga neni 69 paragrafi 1 i LDA-së.

Për më tepër, nëse një transferim i tillë i shpërblimit rregullohet shprehimisht në mënyrë kontraktuale ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, në këtë rast, punëdhënësi duhet ta kërkojë

---

<sup>5</sup> Në veçanti nenin 69 paragrafi 1 i LDA-së i cili thotë: "Nëse punët krijohen nga punëmarrësi sipas kushteve të kontratës së punës, gjatë kryerjes së detyrave dhe udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi i tij, do të konsiderohet se të drejtat pronësore dhe Të drejtat e tjera për këtë punë i kanë kaluar ekskluzivisht punëdhënësit, për një periudhë 3-vjeçare nga data e dorëzimit të punës tek punëdhënësi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë."

këtë shpërblim nga agjencitë e administrimit kolektiv, sepse administrimi i detyrueshëm kolektiv nuk mund të anashkalohet edhe në situata kur pronari i së drejtës është gjithashtu përdoruesi në të njëjtën kohë.

Për shembull, nëse një autor është duke interpretuar veprat e tij në një koncert, organizatori do t'ia paguajë shpërblimin për këtë komunikim në publik agjencisë së administrimit kolektiv dhe kjo e fundit ia kthen atë autorit i cili është në të njëjtën kohë edhe një interpretues dhe ka një marrëveshje të drejtpërdrejtë me organizatorin e koncertit. Kjo është praktika standarde ku administrimi kolektiv është i detyrueshëm. Këto të drejta thjesht nuk mund të ushtrohen individualisht.

Për të përjashtuar “ç) të ardhurat e krijuara nga sponsorizimet, financimet, huatë, grantet, të lidhura dhe të ngjashme” nga të ardhurat bruto që shërbejnë si bazë për llogaritjen e tarifës është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dispozitën eksplicite të LDA-së që thotë kur llogariten tarifat, burimi i të ardhurave - qoftë nga subvencionet, abonimet apo sponsorizimet do të merret parasysh.

Tarifat duhet të rregullohen në një masë më të vogël për të ardhurat që rrjedhin nga subvencionet që mbulojnë kostot operative.

Ato duhet të përshtaten në masë më të madhe për të ardhurat nga shërbimet e abonimit dhe në masën më të madhe për të ardhurat e marra nga reklamuesit dhe sponsorët komercialë (neni 142 paragrafi 6 i LDA). Prandaj, këto të ardhura nuk mund të përjashtohen nga të ardhurat bruto që shërbejnë si bazë për llogaritjen e tarifës së shprehur në përqindje të të ardhurave.

Për të përjashtuar “d) të ardhurat nga punët për të cilat subjekti përdorues ka paguar drejtpërdrejt jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;” nuk është një kriter i qartë. Nuk është e qartë se cilat të ardhura mund të përjashtohen.

Nëse të drejtat ushtrohen në mënyrë të detyrueshme kolektive, siç u shpjegua më sipër, pagesat nuk mund të bëhen drejtpërdrejt dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por vetëm në Republikën e Shqipërisë për përdorime që kanë ndodhur në territorin e Shqipërisë. Të gjitha këto pagesa do të kalojnë detyrimisht përmes agjencisë së administrimit kolektiv.

Duket se përjashtimi i “dh) të ardhurave të krijuara nga shitja ose shpërndarja e të drejtave të programeve dhe paketave të zotëruara me programe të OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;” duhet t'i referohet të ardhurave të krijuara nga shitja ose shpërndarja e prodhimit të brendshëm.

Kjo nuk mund t'i referohet situatave kur të ardhurat krijohen përmes performancës publike, duke përfshirë transmetimin dhe ritransmetimin nga transmetuesi përkatës ose shërbimi i ritransmetimit të përmbajtjes së prodhuar në shtëpi.

Në fakt, vetëm transmetuesit prodhojnë programet e tyre. Operatorët e ritransmetimeve nuk prodhojnë programet e tyre. Nëse programi i shitet një transmetuesi tjetër dhe këto të ardhura gjenerohen, këto të ardhura mund të përjashtohen nga të ardhurat bruto përkatëse për llogaritjen e tarifës, sepse transmetimi i një programi të tillë do të rregullohet ndërmjet organizatës së administrimit kolektiv dhe transmetuesit të dytë.

Ritranstmetimi i përmbajtjes do të rregullohet ndërmjet agjencive të administrimit kolektiv dhe shërbimit të ritransmetimit. Kjo do të thotë se shitja e të drejtave në prodhimet e veta për transmetim të një transmetues tjetër ose për ritransmetim në një shërbim të ritransmetimit mund të përjashtohet nga të ardhurat bruto nëse interpretohet në mënyrën siç është deklaruar nga eksperti.

“e) të ardhurat nga investimet, projektet e zhvillimit teknik, kostot e tjera që lidhen me pagesat e licencave si p.sh. OSHMA-të që nuk lidhen me përdorimin e veprës së mbrojtur me ligj;” mund të përjashtohen nga të ardhurat bruto pasi ato nuk kanë lidhje me veprat dhe çështjet e tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta. Edhe pse, nuk është e qartë se çfarë mund të bëjë një transmetues përveç aktivitetëve që kanë të bëjnë me transmetimin.

Gjithashtu, “ë) të ardhurat e krijuara nga publikimi në rrjetet sociale/internet, shitja apo shpërndarja e të drejtave të programeve dhe paketave të veta me programet e OSHMA-ve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;” mund të përjashtohet nga të ardhurat bruto, të cilat shërbejnë si bazë për llogaritjen e tarifës për transmetim, pasi ajo ka të bëjë me mënyra ose mënyra të tjera të përdorimit të materialit me të drejtë autori.

Për shembull, nëse transmetuesi kryen shërbimin e transmetimit ndihmës nëpërmjet internetit, në këtë rast të drejtat duhet të administrohen nga agjencitë e administrimit kolektiv për komunikimin me publikun e veprave, shfaqjeve dhe fonogrameve, të ndryshme nga transmetimi. Shumë shpesh tarifa do të jetë e njëjtë me atë të transmetimit.

Prandaj, ky përjashtim nuk do të thotë se të drejtat për këtë lloj përdorimi nuk duhet të rregullohen në lidhje me komunikimin me publikun nëpërmjet internetit, përfshirë vënien në dispozicion të publikut.

Përkundrazi, “f) të ardhurat e krijuara nga përdorimi i të drejtave të autorit për të cilat subjekti përdorues hyn në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me autorin/mbajtësin e të drejtave; nuk mund të përjashtohet pasi të drejtat ushtrohen detyrimisht kolektivisht.

Marrëdhëniet kontraktuale individuale dhe të drejtpërdrejta ndërmjet mbajtësit të së drejtës dhe përdoruesit në ato rrethana nuk lejohen ligjërisht.

Nuk është e qartë se çfarë mund të jenë “g) të ardhurat e krijuara nga blerja dhe shitja e veprave/subjekteve që nuk mbrohen me ligj”. Duket se ky përjashtim përputhet me përjashtime të tjera, pjesërisht ose tërësisht.

#### Tarifat e shprehura si një shumë e përgjithshme

Përdorimi i veprave dhe lëndëve të tjera të mbrojtura në njësitë akomoduese si hotele dhe restorante të ngjashme, bare dhe njësi të ngjashme tregtare dhe mjedise të tjera biznesi llogariten si një shumë e përgjithshme.

Kjo është në përputhje me LDA, i cili thotë se kur përdorimi i objektit të mbrojtur nuk është thelbësor për një përdorues, por është i dobishëm ose relaksues (siç janë objektet e akomodimit, vendet e ekspozitës, mjetet e transportit dhe objektet specifike hoteliere), shumat e shpërblimit është e përcaktuar si një shumë e madhe për përdorime të përhershme dhe të rastit (neni 149 paragrafi 5 i LDA).

Metodologjia e pjesës së dytë të tarifës në këtë vendim është në përputhje me metodologjinë nga LDA, pasi që në nenin 149 paragrafi 6 të LDA-së janë të rregulluara kriteret për caktimin e tarifës paushall si: rrethanat e shfrytëzimit, lloji i përdorimit, vendi dhe vendndodhja gjeografike, kategoria dhe madhësia e objekteve, kohëzgjatja dhe numri i përdorimeve dhe diferenca e çmimeve në lidhje me biznesin e një përdoruesi.

Për shembull, llogaritja e tarifës për hotelet dhe akomodimet e ngjashme bazohet në metodologjinë që përfshin përcjellësin qendror, çdo altoparant, çdo pajisje gjurmuese të dhomës dhe çdo pajisje gjurmuese në zonat e përbashkëta të akomodimit. Për më tepër, tarifa varet nga vendndodhja

gjeografike e akomodimit, përkatësisht nga atraktiviteti i vendndodhjes gjeografike. Vendndodhjet më tërheqëse kanë 100% të tarifës së përcaktuar, dhe më pak tërheqëse kanë 80% dhe 70% të tarifës. Metodologjia është në përputhje me LDA.

Për restorantet, baret dhe të ngjashme, metodologjia mbështetet në orët e punës, kapacitetin e vendit dhe ditët e punës gjatë javës. Metodologjia e përmendur në thelb korrespondon me kërkesat e LDA.

#### Analizë e Vendimit të Këshillit Kombëtar të së Drejtës së Autorit Nr.2 datë 22.6.2018

Në vendimin e Këshillit Kombëtar të së Drejtës së Autorit nr. 2, datë 22.6.2018, u zgjerua lista e përjashtimeve nga të ardhurat bruto për llogaritjen e tarifës në bazë të përqindjes për transmetimin e veprave të së drejtës së autorit dhe lëndëve të mbrojtura nga të drejtat e përafërta. Ndryshimet janë bërë në bazë të sugjerimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, përkatësisht transmetuesit.

Përjashtimet janë si më poshtë:

- a) të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të OSHMA-ve, si shitja e mallrave dhe produkteve;
- b) Shumat e grumbulluara për prodhimin/financimin e një programi audiovizual të porositur nga një OSHMA;
- c) rikuperimin e shumës së paguar për të përfituar të drejtat ekskluzive të transmetimit kombëtar ose lokal të një ngjarjeje sportive, duke përfshirë të gjitha llojet e sporteve dhe aktiviteteve të tjera në shërbimin e tyre që nuk përdorin vepra të të drejtave të autorit; Nëse OSHMA mund të provojë se ka paguar tarifa normale për kohën dhe pajisjet e stacionit si dhe të ardhurat nga kostot teknike të transmetimit; Përfshirë të ardhurat nga reklamat gjatë ngjarjeve sportive;
- ç) të gjitha të ardhurat nga reklamat për prodhimet e veta të OSHMA-së, reklamat e transmetuara para, gjatë dhe në fund të këtyre prodhimeve;
- d) të gjitha të ardhurat e siguruara nga përdorimi i veprave të mbrojtura që krijohen gjatë marrëdhënies së punës;
- dh) të gjitha të ardhurat e krijuara nga sponsorizimet, financimet, huatë, grantet, të lidhura ose të ngjashme;
- e) të gjitha të ardhurat për veprat e mbrojtura për të cilat OSHMA ka paguar drejtpërdrejt jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas marrëveshjeve me titullarët e të drejtave;
- ë) të gjitha të ardhurat e krijuara nga shitja ose shpërndarja e të drejtave të programeve të veta dhe paketave programore të OSHMA brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë;
- f) të gjitha të ardhurat nga investimet, projektet e zhvillimit teknik, të ardhurat nga dhënia me qira e ambienteve apo asetëve (pasuri të paluajtshme), kosto të tjera që lidhen me pagesat e licencimit si OSHMA që nuk kanë lidhje me përdorimin e veprave të mbrojtura me të drejtë autori;
- g) Të gjitha të ardhurat që krijohen nga publikimi në rrjetet sociale/internet, shitja apo shpërndarja e të drejtave të zotërimit të programeve dhe paketave me programet e veta të OSHMA brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- gj) Të gjitha të ardhurat e krijuara nga përdorimi i të drejtave të autorit për të cilat përdoruesi (OSHMA) hyn në një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me autorin/bartësin e së drejtës për



administrimin e detyrueshëm kolektiv kur të gjitha palët kontraktuese kanë hequr dorë nga kjo administrim sipas dispozitave ligjore në fuqi;

h) Në rastin e OSHMA me pagesë (pay TV) të paketave të abonimit dhe eventeve pay-per-vieë, të ardhurat nga këto të fundit vlerësohen në lidhje me përdorimin e veprës së mbrojtur dhe jo si të ardhura në përgjithësi. Në rastet kur këto të ardhura nuk mund të përcaktohen, llogariten kostot e blerjes së veprave të mbrojtura nga titullari;

1) në rastin e transmetuesit publik RTSH (Radio Televizioni Shqiptar), përjashtohen vetëm të ardhurat sipas shkronjës “ç” të nenit 116 të ligjit 97/2013.

i) për OSHMA-të që përsërisin/ritransmetojnë sinjalin e një OSHMA tjetër në kohë reale, të ardhurat bruto konsiderohen të përfituara drejtpërdrejt nga ky i fundit, duke përjashtuar atë pjesë të të ardhurave që i paguhet drejtpërdrejt mbajtësit të së drejtës që ata ofrojnë për të ritransmetuar të drejtat ;

j) të ardhurat e krijuara nga blerja ose shitja e veprave/ngjarjeve të pambrojtura me ligj.

Përjashtimet e rregulluara në pikat a), ç), d), dh), e), ë), f), g), dhe j) janë të njëjta ose të ngjashme me përjashtimet në vendimin e mëparshëm dhe për këtë arsye nuk do të analizohen përsëri në këtë kapitull. Gjithçka që u tha për këto përjashtime në Vendimin e mëparshëm të KKDA-së mbetet e njëjtë në lidhje me këtë vendim.

Lidhur me “b) shumat e mbledhura për prodhimin/financimin e një programi audiovizual të porositur nga një OSHMA”, nuk është e qartë se si mund të “mbledhen” ato “shuma”. Duhet të shmangen kriteret e paqarta dhe të paqarta për llogaritjen e tarifave. Gjithashtu, duket se kjo është një e ardhur e rregullt për organizatat transmetuese për kryerjen e tyre të rregullt të programeve nga producentë të pavarur. Nuk ka asnjë arsye për të përjashtuar këto të ardhura. Ky përjashtim nuk bazohet në LDA kryesisht sepse varet nga plani i biznesit të transmetuesit dhe ndarja e buxheteve.

Pika c) i referohet të ardhurave që lidhen me të gjitha llojet e ngjarjeve sportive të transmetuara, veçanërisht të ardhurat e krijuara nga reklamat gjatë ngjarjeve sportive të transmetuara. Këto të ardhura shpesh janë të çmuara.

*Së pari*, gjatë ngjarjeve sportive, muzika kryhet edhe në pauza dhe në fillim dhe në fund, veçanërisht në reklama. Muzika është pjesë e rregullt e këtij formati të veprave audiovizuale dhe përdoren lloje të ndryshme shenjash dhe tingujsh muzikorë. Pra, përjashtimi i këtyre të ardhurave nga të ardhurat bruto nuk duket të bazohet në argumentin se muzika nuk përdoret gjatë atyre llojeve të shfaqjeve audiovizive.

Gërma l) tregon kriteret që nuk mund të përcaktohen lehtë dhe thjesht nëse mund të përcaktohen dhe dallohen fare. Duket se këto kriteret janë të paqarta dhe për këtë arsye duhen shmangur.

Gërma i) tregon kriteret që gjithashtu nuk janë qartë të kuptueshme dhe për këtë arsye duhen shmangur.

*Si përfundim*, shumica e përjashtimeve të rregulluara në këtë vendim nuk janë në përputhje me dispozitat e LDA, që do të thotë se nuk janë në përputhje me metodologjinë dhe kriteret për vendosjen e tarifave nga LDA të përshkruara dhe analizuara më parë në këtë tekst në lidhje me këtë vendim.

*Ndryshimet me Metodologjinë e mëparshme*

Këshilli Kombëtar i së Drejtës së Autorit (KKDA) me Vendimin nr. 3, datë 4.8.2017, ka miratuar metodologjinë dhe masën e tarifave në tarifën e veprave të mbrojtura dhe çështje të tjera, e cila është ende në fuqi.

KKDA ka përcaktuar të ardhurat bruto si të ardhura nga aktiviteti i përdorimit të deklaruara në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të përdoruesit.”

Sipas të njëjtit Vendim, në të ardhurat bruto nga aktiviteti vjetor i përdoruesit nuk përfshihen:

a) të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga aktivitete të tjera të transmetuesve, si shitja e mallrave dhe produkteve;

b) të ardhurat nga reklamat për produktet e vetë OSHMA<sup>6</sup>;

<b>Metodologjia për performancat live sipas AAK-së UCMR-ADA:</b>	<p>Mënyra dhe kriteret si bazohet tarifa</p> <p><b>Kriteret:</b>            Baza e llogaritjes për honoraret në përqindje përbëhet nga:            A. Të ardhurat pa TVSH të marra nga përdoruesit nga përdorimi i veprave muzikore në koncerte, shfaqje apo ngjarje artistike si:            a) shitjet e biletave për shfaqjen, koncertin ose ngjarjen artistike            b) të ardhurat e përfituara nga reklamat e ofruara nga shfaqjet, koncertet ose ngjarjet artistike;            c) të ardhurat e përfituara nga transmetimi i shfaqjes, koncertit ose ngjarjes artistike;            d) të ardhurat nga sponsorizimet e marra për shfaqjen, koncertin ose ngjarjen artistike;            e) ndarja buxhetore ose çdo financim tjetër për çmimin e biletave të shfaqjes;</p> <p><b>Disa shembuj:</b>            Koncerte dhe shfaqje me muzikën si tipar kryesor            1. Koncert Opera - 8% tarifa;            2. Karaoke - 4% tarifa;</p>

<b>REPUBLIKA E GREQISË</b>
----------------------------

<b>Metodologjia për performancat live sipas AAK-së AUTODIA 2018:</b>	Mënyra dhe kriteret si bazohet tarifa																															
	<p><b>Kriteret:</b> Kjo kategori përfshin të gjitha objektet, bizneset dhe mjediset që funksionojnë si vende të argëtojnë dhe përdorin muzikë live për argëtimin e klientëve të tyre. Edhe kjo kategori përfshin sallat muzikore, d.m.th ambientet që funksionojnë si vende argëtimi, duke u ofruar klientëve muzikë live për argëtimin e tyre.</p> <p><b>Tarifat mujore:</b></p> <table> <thead> <tr> <th>Sipërfaqja m<sup>2</sup></th> <th>Komunat/Ishujt e mëdhenj</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>0-100</td><td>€ 218</td></tr> <tr><td>101-200</td><td>€ 351</td></tr> <tr><td>201-300</td><td>€ 526</td></tr> <tr><td>301-400</td><td>€ 818</td></tr> <tr><td>401-600</td><td>€ 1,380</td></tr> <tr><td>601-800</td><td>€ 1,656</td></tr> <tr><td>801-1000</td><td>€ 1,863</td></tr> <tr><td>1001-1200</td><td>€ 2,124</td></tr> <tr><td>1201-1400</td><td>€ 2,354</td></tr> <tr><td>1401-1600</td><td>€ 2,556</td></tr> <tr><td>1601-1800</td><td>€ 2,731</td></tr> <tr><td>1801-2000</td><td>€ 2,883</td></tr> <tr><td>2001-2500</td><td>€ 3,424</td></tr> <tr><td>2501-3000</td><td>€ 3.903</td></tr> <tr><td colspan="2">Për çdo 100 m2 shtesë 96 €</td></tr> </tbody> </table>	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Komunat/Ishujt e mëdhenj	0-100	€ 218	101-200	€ 351	201-300	€ 526	301-400	€ 818	401-600	€ 1,380	601-800	€ 1,656	801-1000	€ 1,863	1001-1200	€ 2,124	1201-1400	€ 2,354	1401-1600	€ 2,556	1601-1800	€ 2,731	1801-2000	€ 2,883	2001-2500	€ 3,424	2501-3000	€ 3.903	Për çdo 100 m2 shtesë 96 €
Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Komunat/Ishujt e mëdhenj																															
0-100	€ 218																															
101-200	€ 351																															
201-300	€ 526																															
301-400	€ 818																															
401-600	€ 1,380																															
601-800	€ 1,656																															
801-1000	€ 1,863																															
1001-1200	€ 2,124																															
1201-1400	€ 2,354																															
1401-1600	€ 2,556																															
1601-1800	€ 2,731																															
1801-2000	€ 2,883																															
2001-2500	€ 3,424																															
2501-3000	€ 3.903																															
Për çdo 100 m2 shtesë 96 €																																

## 9. TARIFAT E PROPOZUARA NGA AAK-TË NË SHQIPËRI

**Tabela 6**

<b>TARIFAT E PROPOZUARA NGA AAK-TË</b>
--

**Tarifat e propozuar nga AAK-të për përdoruesit:**

**Kategoria 1 (Parësore) – Tarifat 3% të të ardhurave bruto:**

1. OSHMA (Televizione, Radio, Kabllor) ;
2. Koncertet ;
3. Kinematë, disko, klube nate.

**Kategoria 2 (Dytësore) – Tarifat 1% të të ardhurave bruto:**

1. Dyqane, njësitë tregtare;
2. Lokale, hotele, restorante;
3. Taxi, palestra, Spa.

**Kategoria 3 – Tarifat 7 euro për abonent (aparati):**

1. Platformat digjitale, IPTV, OTT.

Tarifat si më lart janë propozuar me vendim nga organi më i lartë vendimarrës i Sportelit Unik. Në votimin e kryer në këtë vendim Agjencia “Albautor” nuk shprehur dakortësinë e saj, që të gjithë subjektet të paguajnë në bazë të ardhurave bruto dhe ka votuar kundër.

1. Subjektet Përdorues të tillë si “Strukturat Akomoduese”, “Vendet ku konsumohet ushqim dhe/ose pije”, “Njësitë tregtare dhe mjedise të tjera biznesi”, “Të tjera aktivitete biznesi” ku komunikohen në publik veprat e mbrojtura, duke ju referuar metodologjisë së R.Sh apo edhe metodologjive të pasqyruara në tabelat si më lart, si dhe shumë AAK-ve anëtare të CISAC— the International Confederation of Societies of Authors and Composers e përbërë nga 228 anëtarë, kryejnë pagesa në bazë të disa kriterëve të parashikuara në metodologji, sipas deklarimeve të kryera prej tyre.

Vlera për këto subjekte nuk përcaktohet në bazë të ardhurave bruto, në dallim me subjektet Radio apo Televizione.

2. Metodologjia në R.SH përfshinë tarifën për të gjithë kategoritë e mbajtësve të të drejtave të përfaqësuara nga AAK-të.

Në shtetet e tjera metodologjia për tarifën gjendet në mënyrë të pavarur në AAK-në përkatëse, sipas kategorisë që ajo përfaqëson.

## **TË DHËNA MAKROEKONOMIKE DHE TREGUESË ANALITIKË<sup>7</sup>**

Me qëllim që për të hartuar një metodologji me informacion të plotë në nivel kombëtar dhe që të përfshijë sa më shumë gjithë tendencat e mundshme të zhvillimit të sektorëve, ky relacion ndalet fillimisht në analizën e rritjes ekonomike, e cila është në nivelin historik të saj, për të parë edhe tendencën historike dhe një vlerësim për llogaritjet për të ardhmen.

<sup>7</sup> Të dhënat e informacionit në këtë shërbim ne i kemi përkthyer në anglisht, për të qenë më pranë nevojave për disponueshmëri, shpejtësi dhe lehtësim të të kuptuarit të përmbajtjes së tyre



Ecuria Vjetore e PBB (vit/vit), 2009-2023															në %
Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Ecuria	3,3	3,7	2,5	1,4	1,0	1,8	2,2	3,3	3,8	4,0	2,1	-3,96	8,54	4,84	3,7
Burimi: MFE, BSH, FMN, BB, INSTAT															

Në vijim të llogaritjes dhe për të ditur se sa janë dimensionet e ekonomisë shqiptare, në të cilën operojnë dhe kontribuojnë edhe përdoruesit e të drejtës së autorit, më poshtë janë vendosur të dhënat historike të vlerës absolute të Prodhimit të Brendshëm Bruto në një qasje tendence historike të saj, për të kuptuar edhe zgjerimin në vitet e kaluara dhe atë që mund të të pritët në të ardhmen.

Kjo pritshmëri e dimesioneve ekonomike plotësohet edhe nga llogaritjet që janë vendosur në të dhënat e tjera tabelare që vijojnë.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), 1999 - 2023																							milard Lekë		
Emërtimi	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023*
PBB	506.2	523	583.3	622.7	694.1	750.8	814.8	882.2	966.6	1087.8	1,144.00	1,239.00	1,300.60	1,332.80	1,350.10	1,395.30	1,434.30	1,472.50	1,550.60	1,636.70	1,691.70	1,644.10	1,856.20	2,138.30	2,311.70
Burimi: MF, BSH, INSTAT																									

Të dhënat e mëposhtme prezantojnë vlerën e ekonomisë më nga afër në vitet e fundit lidhur me zhvillimet e ekonomisë dhe madhësinë e saj sipas rajoneve të vendit, duke kuptuar më mirë dhe më nga afër se çfarë zhvillimesh dhe tendencash ka marrë ekonomia në secilin rajon dhe si mund të jetë pritshmëria e saj edhe për të ardhmen.

Brenda kësaj ekonomie sipas të dhënave në tabelë janë edhe vlerat ekonomike të përdoruesve të të drejtës së autorit (Hotelet, baret, restorantet, aktivitetet tregtare, televizionet, radiot, portalet etj.)

Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korente, 2017-2021					
	Milion leke				
Rajoni	2017	2018	2019	2020	2021
Berat	58,833	58,547	57,883	57,835	62,201
Dibër	49,260	52,106	51,112	48,039	53,504
Durrës	156,857	162,378	171,576	163,631	186,709
Elbasan	105,598	110,379	111,830	112,749	124,976
Fier	165,990	178,368	188,442	179,915	201,532
Gjirokastrë	34,491	35,572	37,087	36,207	38,674
Korçë	84,713	87,837	90,725	88,767	96,586
Kukës	26,474	27,936	27,362	27,178	29,027
Lezhë	50,557	50,972	53,262	50,065	54,831
Shkodër	79,997	83,618	86,017	81,936	91,117
Tiranë	651,015	696,952	723,294	707,631	811,443
Vlorë	86,859	92,067	93,312	93,479	105,571
<b>Gjithsej</b>	<b>1,550,644</b>	<b>1,636,732</b>	<b>1,691,902</b>	<b>1,647,432</b>	<b>1,856,171</b>
Burimi: INSTAT					

Nëpënjt treguesve në tabelën më poshtë pasqyrohet drejtë vlera e ekonomisë rajonale sipas çmimeve aktuale, për të kuptuar se sa realisht ajo është e vlefshme në këtë kohë që tendencat e çmimeve janë rritur duke ndikuar jo vetëm në çmimet e produkteve dhe shërbimeve, por edhe vlerës mbi të cilën do të bazohet llogaritja e tarifës së re të të drejtës për autorët.

Pesha e rajoneve sipas Produktit Brendshëm Bruto me çmime korente, 2017-2021					
Rajoni	%				
	2017	2018	2019	2020	2021
Berat	4%	4%	3%	4%	3%
Dibër	3%	3%	3%	3%	3%
Durrës	10%	10%	10%	10%	10%
Elbasan	7%	7%	7%	7%	7%
Fier	11%	11%	11%	11%	11%
Gjirokastër	2%	2%	2%	2%	2%
Korçë	5%	5%	5%	5%	5%
Kukës	2%	2%	2%	2%	2%
Lezhë	3%	3%	3%	3%	3%
Shkodër	5%	5%	5%	5%	5%
Tiranë	42%	43%	43%	43%	44%
Vlorë	6%	6%	6%	6%	6%

Përveç ndikimit që shikojmë nga pesha e ekonomisë së rajoneve në varësi të çmimeve të tregut, më poshtë jemi fokusuar edhe më thellë në ekonominë rajonale për të verifikuar specifikisht sektorët ekonomikë të lidhur direkt me përdorimin e të drejtës së autorit. Këta sektorë të identifikuar janë Tregtia, transporti, hoteleria dhe restoratnet, si dhe sektori i arteve, argetimit, çlodhjes bashke me aktivitetet të lidhura me to.

Nëpërmjet analizës së bazuar mbi këta tregus arrihet në një konkluzion se pesha e tyre e konsiderueshme sipas peshës që mbajnë në prodhimin e brendshëm ndikon në një llogaritje të duhur të proporcionit që do të llogaritet dhe do të diskutohet me gjithë kategoritë e përdoruesve të të drejtës së autorit, për të patur sa më pak arsye dhe shmangie nga argumenti ekonomik.

Dimensionet ekonomike të sektorëve më poshtë janë edhe korniza më e plotë që mund të jepet për të llogaritur tashmë në nivel biznesesh që janë të lidhura me të drejtën e autorit.

Prodhimimi i brendshëm sipas Rajoneve, 2022												
Sektorët	BR	DI	DR	EL	FR	GJ	KO	KU	LE	SH	TR	VL
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	48.6	41	15.3	39	47.9	28.1	43.2	38.1	30.3	29.9	3.6	27.3
Industria nxjerrëse; Përpunuese; Energjia; Ujë Ndërtim	11	25.2	18.7	15.3	16.5	10.5	8.6	13.4	9.4	16.2	10.6	9.4
Tregtia; Transport; Hotele	6.6	4.1	10.8	8.1	5.9	8.9	5.4	6.2	11.4	9.2	14.2	13.3
Informacioni dhe komunikacioni	11.2	6.7	25.6	12.3	11.7	19.5	15.5	9	17.7	13.3	23	18.4
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	1.4	1.3	1.2	1	0.9	2	1.4	1.7	1.4	1.6	6.3	1.7
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	3	2.7	2.3	2	1.7	3.5	2.8	2.5	4	2.1	2.3	2.5
Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike	3.3	3.1	9.5	5.1	3.9	4.2	5.4	4	6.5	6.9	7.3	8.9
Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj.	1.3	1.7	6.3	2	2.7	3.9	1.6	1.3	2	3.2	12.1	3.9
Arte, argëtim; çlodhje etj.	12.9	13.6	8.5	14	7.8	18.1	14.3	23.2	15.1	15.3	16.6	12.7
Arte, argëtim; çlodhje etj.	0.7	0.6	1.8	1.2	0.9	1.2	1.8	0.6	2.1	2.3	4	1.9

[https://www.instat.gov.al/media/11570/pbb-rajonale-2021-shqip\\_njoftim-per-media.pdf](https://www.instat.gov.al/media/11570/pbb-rajonale-2021-shqip_njoftim-per-media.pdf)

<https://www.instat.gov.al/media/4639/material-metodologjik-llogaritje-rajonale.pdf>

Për të kuptuar më drejt ekonomitë e rajoneve të vendit, të dhënat e mëposhtme tregojnë se sa është potenciali i matshëm i konsumatorëve që janë klientët potencialë të përdoruesve të të drejtës autoriale (Aktiviteteve tregtare dhe të shërbimit e prodhimit).

Popullsia sipas rajoneve, 2023	
Numri banorëve	Numri
Berat	111,431
Dibër	106,380
Durrës	289,797
Elbasan	252,719
Fier	271,672
Gjirokastrë	53,314
Korçë	192,925
Kukës	71,498
Lezhë	114,181
Shkodër	189,164
Tiranë	925,268
Vlorë	183,436
<b>Gjithsej</b>	<b>2,761,785</b>
Burimi: INSTAT	

Nëpërmjet kësaj të është ideur dhe koordinuar në mënyrën se sa dhe si duhet të draftohet pjesa për llogaritjen për çdo rajon të lidhur ngushtë me të dhënat ekonomike dhe ato të popullsisë që konsumon bashkë me produktet edhe veprat e autorëve në blerjet dhe pagesat që ata bëjnë.

Numri i banoreve dhe krahasimi i tyre me të ardhurat për frymë mesatare, nivelin e pagave, si dhe me madhësinë e sektorëve ku e drejta e autorit është potencialisht e përdorshme krijojnë një mundësi të dukshme për të mos shpëtuar nga barra e pageses për perdorimin e te drejtes se autorit. Ky argument gjithsesi nuk ishte shterues në analizën e kësaj metodologjie pasi është vetëm një moment në analizën për të rritur forcën e argumenteve ekonomike për ta patur të qartë se sa është realisht edhe pesha e tarifës që do të llogaritet nga metodologjia në raport me gjithë të ardhurat e aktivitetit për secilën kategori të përdoruesve. Numri i popullsisë si më lart jep edhe treguesin e një numri mesatar të konsumatorëve për sektor dhe njësi biznesi duke e llogaritur edhe me vlerën reale të fuqisë blerëse të tyre sipas të dhënave të natyrave të ndryshme që kryqëzohen dhe i shërbejnë llogaritjes së një vlere sa më të drejtë tarifore të pagesës nga përdoruesit.

Nëpërmjet tabelës më poshtë japim të kuptojmë se sa janë potencialet e fuqisë blerëse të popullsisë së vendit. Nga e dhëna e përpunuar edhe në Euro dhe Dollar ne duam të studiojmë se sa është potenciali i mundshëm mesatar i fuqisë blerëse, pasi nga e ardhura për person kuptohet më mirë edhe mundësia e tyre për të shpenzuar.

PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO (PBB) PËR BANOR NË SHQIPËRI, 2002 -2022																					
PBB për frymë	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022 <sup>1</sup>
PBB/Banor (Lek) <sup>1</sup>	197 063	200 653	224 495	260 241	278 453	298 493	397 541	386 643	429 697	466 250	452 667	451 813	520 312	500 583	529 081	510 009	573 345	593 258	596 886	659 744	736 741
Rritja LEK (vit/vit)	8,5%	1,8%	11,9%	15,9%	7,0%	7,2%	33,2%	-2,7%	11,1%	8,5%	-2,9%	-0,2%	15,2%	-3,8%	5,7%	-3,6%	12,4%	3,5%	0,6%	10,5%	11,7%
PBB/Banor USd <sup>2</sup>	1425,1	1846,1	2373,6	2673,8	2972,7	3595,0	4370,5	4114,1	4094,3	4437,1	4247,6	4413,1	4578,6	3952,8	4124,1	4531,0	5287,7	5396,2	5332,2	6492,9	6789,0
Rritja US.D (vit/vit)	-99,2%	29,5%	28,6%	12,6%	11,2%	20,9%	21,6%	-5,9%	-0,5%	8,4%	-4,3%	3,9%	3,8%	-13,7%	4,3%	9,9%	16,7%	2,1%	-1,2%	21,8%	4,6%
PBB/Banor (Euro <sup>3</sup> )	1436,5	1534,5	1771,2	2129,4	2250,3	2468,3	3226,7	2838,7	3095,3	3370,4	3238,8	3221,6	3714,6	3637,0	3912,9	3826,9	4653,2	4855,5	4888,6	5337,2	6412,2
Rritja Euro (vit/vit)	-99,2%	6,8%	15,4%	20,2%	5,7%	9,7%	30,7%	-12,0%	9,0%	8,9%	-3,9%	-0,5%	15,3%	-2,1%	7,6%	-2,2%	21,6%	4,3%	0,7%	9,2%	20,1%

<sup>1</sup> <https://www.instat.gov.al/statistika/t%C3%AB-dh%C3%ABna-ky%C3%A7e/>  
<https://financa.gov.al/treguesit-e-borxhit/>

<sup>2</sup> <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD?locations=AL>

<sup>3</sup> [https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

Për të patur më të qartë tendencën e të ardhurave për frymë kemi marrë në analizë edhe nivelin e pagës minimale, me anë të të cilës paguhen deri 56% e gjithë të punësuarve në vend, si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Paga minimale është edhe një tregues bazik për fuqinë blerëse aktuale dhe tendencën e ardhme

Paga minimale zyrtare (LEK/MUAJ)											Lek/Muaj
Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Paga minimale zyrtare	22,000	22,000	22,000	22,000	24,000	24,000	26,000	26,000	30,000	34,000	40,000
Burimi: MF, INSTAT											

Po kështu për të parë përtej pagës minimale më poshtë në tabelë janë vendosur edhe disa kategori të punonjësve që marrin paga mesatare apo edhe të larta, duke analizuar edhe se si kjo kategori e konsumatorëve janë të lidhur me konsumin nëpërmjet pagës. Treguesi i pagës mesatare është edhe një nivel tregues për tendencën e ardhme konsumatore që mund të krahasohet me atë që ndodh me këtë kategori edhe në vendet e tjera. Paga e mesme është edhe niveli më i pranueshëm për të parë se sa rezistente do të jetë tendenca ekonomike dhe fuqia blerëse për të ardhmen, duke konsideruar se paga mesatare ka tendencë të rritet më tej në vitet në vijim.

Paga mesatare (sektori publik dhe privat) 2000 - 2020																			000 Lekë		
Vitet	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	24.4	29	34.5	37.2	37.55	44.3	51	59.2	60.5	71.5	73.5	76.5	81.7	82	82.4	82.8	83.5	84.4	86.5	87.5	88.8
Specialistë	18.2	20.2	23.1	26	27.02	29.9	33.4	39.1	42.5	50.3	55.3	58.9	60	60.8	61	61.2	61.6	62.5	64.4	68.6	70.1
Teknikë dhe ndihmës specialistë	13.5	16.3	18.3	19.4	20.05	24.5	25.9	31.3	33.6	40.7	43	45.3	46.3	47.3	47.4	48.7	49.1	55.1	56.8	56.7	59
Nëpunës të thjeshtë	14.4	15.6	17	20.3	21.25	23.9	24.2	27.8	29.6	34	36.2	37.9	40	41	41.1	42	42.4	48.9	51	52.1	54
Punëtorë	12.4	13.8	14.5	16.8	17.08	19.6	21.3	23.9	25.1	31.5	33.8	36	36.1	36.9	37.1	37.5	37.9	40	42.2	46.2	47.1
Paga mesatare	16.6	19	21.5	23.9	24.59	28.4	31.2	36.3	38.3	45.6	48.3	50.9	52.8	53.6	53.8	54.4	54.9	58.2	60.2	62.2	63.8
Burimi: INSTAT																					

Tabela më poshtë është për të kuptuar realisht se sa nga të ardhurat e konsumatorëve grryhen nga niveli i inflacionit, me qëllimin që të korrektohet vlera e përlllogaritur si potencialisht e vlefshme për të shkuar drejt konsumit dhe përfshirjes në ekonominë e vendit ku ka rezeidencën konsumatori.

Ndryshimi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit												%
Vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	
Inflacioni	2.1	1.6	1.8	1.3	2	2	1.4	1.6	2	6.7	4.8	
Burimi: BSH, INSTAT												

Nëpërjet tabelës më poshtë, duke qenë se pjesa kryesore e të ardhurave të përdoruesve të të drejtës së autorit është e lidhur me qarkullimin brenda vendit të vizitorëve shqiptarë dhe të huaj në japim të kuptojmë edhe përqëndrimin e tyre sipas zonave të vendit (Jug, qendër, veri), por edhe për të kuptuar nëpërmjet të dhënave të tjera që konsiderojmë se sa është potenciali, që lidhet me faktorë jashtë tregut dhe ekonomisë shqiptare, me turistët e huaj.

Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj në Shqipëri sipas rajonit		
Rajoni	Numër	
	Vizitorë të huaj	Vizitorë vendas
Jugu i vendit	229,460	309,910
Qendra	410,030	237,323
Veriu i vendit	247,025	145,234
<b>Gjithsej</b>	<b>886,515</b>	<b>692,467</b>

Tabela me të dhënat e përpunuara si më poshtë është informacion që realisht vlen për arsyen se kutpojmë se sa nga vizitorët e huaj janë konsumatorë direkt të shërbimeve që ofrohen nga bizneset shqiptare dhe sa nga ata nuk mund të përfshinë si numra në llogaritje. Kjo mënyrë e llogaritjeve shërben edhe për të korrigjuar llogaritjet si më lart dhe të kutpojmë më nga afër vlerat e mundshme që mund të gjenerojnë bizneset.

Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas qëllimit dhe destinacionit, viti 2022

Rajoni	Pushime	Vizita te miq	Tjetër	%
				Biznes
Berat	1.2	4.5	4.5	2.6
Dibër	0.5	6.4	2.6	18.3
Durrës	17.8	9.9	10.6	8.7
Elbasan	0.8	9.2	10.6	8.7
Fier	0.4	3.1	6.3	13
Gjirokastrë	1.4	5.1	0.1	0.8
Korçë	26	9.8	4.1	2.6
Kukës	1	3.8	2.7	0
Lezhë	2.7	11.4	1.9	0.4
Shkodër	3.4	4.7	1.4	6.3
Tiranë	10.4	28.9	61.7	28
Vlorë	34.3	3.2	2	17
Burimi: INSTAT				

Nëpërmjet tabelës me informacionin si më poshtë ne shikojmë se si është shpërndarja e tyre gjatë periudhave të vitit, duke kuptuar më mirë edhe mënyrën se si është kulmi dhe momentet e tjera jo kulmore të bizneseve të lidhura ngushtë me klientët vendas dhe sidomos të huajt.

Rajoni	Shpërndarja e udhëtimeve në Shqipëri sipas tremujorit, viti 2022				%
	Tr. I	Tr. II	Tr. III	Tr. IV	
Berat	4.1	3.3	6.8	5	
Dibër	4.5	5.2	8.1	5.8	
Durrës	8.7	6.9	5.6	14	
Elbasan	10.5	10.7	12.1	9.9	
Fier	5.4	7.5	6.6	8	
Gjirokastrë	3	1.7	1	1.2	
Korçë	4.7	5.1	6.3	5.4	
Kukës	6.8	7	4.1	6.2	
Lezhë	7.3	4.8	5.1	9.8	
Shkodër	6.2	5.6	2.6	4.1	
Tiranë	32.9	38.1	38.9	30.1	
Vlorë	5.8	4.1	2.6	0.5	
Burimi: INSTAT					

Me hyrjen në nivelin e xhiros së secilit sektor të ekonomisë, sipas analizimit me rajone arrijmë të këqijve më shumë në mënyrën se si janë të shpërndarë të ardhurat e përdoruesve, veçanërisht të atyre që janë të lidhur direkt me përdorimin e të drejtës së autorit. Kjo edhe më diskutuar edhe për qëllimin direkt të llogaritjes së tarifës ka një vlerë në kontekstin e gjithë sa kemi për llogaritje

si më lart. Me anë të saj tashmë shikojmë në nivel xhiro se sa realisht janë potencialet e të ardhurave dhe baza e madhe e llogaritjes për momentin e dreftit të tarifave.

Xhiro vjetore e ndermarrjeve sipas aktivitetit ekonomik dhe qarqeve (në %), 2022								
Rajoni	Akomo							
	Bujqësia	Industria	Ndërtim	Tregtia	Transpo dimi dhe	IT dhe k	Te tjera	
Berat	4.6	1.2	1	1.5	1.1	1.4	0.3	1.9
Dibër	0.7	1.7	1.8	0.9	0.6	0.9	0.4	1.4
Durrës	19.9	8.9	5.2	18.9	27.4	10.7	1.2	5.5
Elbasan	2.1	4	3.2	3	1.7	3.5	0.4	2.1
Fier	23.3	7	6	6.6	3.4	3.4	0.5	2.1
Gjirokastrë	1.1	0.9	1.2	3.5	1.2	1.1	0.1	1.7
Korçë	2.8	1.5	0.8	2.7	2.7	4.1	0.3	1
Kukës	0.1	0.3	0.6	1.2	0.4	0.7	0.1	1.4
Lezhë	3.4	1.2	2.2	2.1	1.2	5.7	0.2	2
Shkodër	9.9	2.1	2.5	2.6	1.5	3.9	1	2
Tiranë	18	69.7	70.1	53.7	56	50.8	94.7	76.1
Vlorë	13.9	1.5	5.4	3.4	2.8	13.9	0.9	2.8
Burimi: INSTAT								

Me qëllim që të kryqëzojmë llogaritjet dhe për të patur një informacion edhe më të detajuar se sa deri prezantuar më lart, nëpërmjet të dhënave në tabelat më poshtë me të dhënat aktuale për numrin e njësive akomoduese dhe numrin e dhomave ne i kemi parë si një pjesë e rëndësishme e segmentit të përdoruesve të të drejtës së autorit. Nëse i shikojmë këto të dhënë në kuptimin e xhiros së sektorit që përfshin edhe akomodimin, ne arrijmë të bëjmë më mirë edhe analizën për shërbimet dhe aktivitetet e tjera, që përdorin të drejtat e autorit.

Numri mesatar i dhomave të disponueshme dhe numri mesatar i dhomave të zëna sipas rajonit		
Rajoni	Viti 2022	
	Dhoma te zena	Dhoma gjithsej
Jugu i vendit	43,414	217,200
Qendra	58,270	292,403
Veriu i vendit	29,897	185,679
<b>Gjithsej</b>	<b>131,581</b>	<b>695,282</b>
Burimi: INSTAT		

Numri i strukturave akomoduese (hotele, motele, kampe, bujtina, streha malore dhe struktura të tjera për qëndrime afatshkurtra) sipas qarkut, 2020 – 2022		
Rajoni	Numer	
	2021	2022
Berat	49	49
Dibër	23	28
Durrës	110	135
Elbasan	52	58
Fier	45	48
Gjirokastër	52	55
Korçë	110	115
Kukës	21	23
Lezhë	72	78
Shkodër	150	150
Tiranë	400	410
Vlorë	330	390
Burimi: INSTAT		

Gjithashtu janë analizuar për të lidhur të dhënat ekonomike me numrin e përdoruesve edhe segmentin e çdo aktiviteti në Shqipëri duke e analizuar dhe kategorizuar në varësi të xhiros që ata deklarojnë në organet tatimore.

Rezulton se për:

- tregtinë, ku përfshihen kryesisht edhe supermarketet dhe njesitë e tregtimit të cilat janë të ndara edhe në numër sipas nivelit të xhiros së tyre
- hotelet dhe restorantet e baret
- transporti dhe telekomunikacioni

bëjmë kryqëzimin e të dhënave për numrin e bizneseve dhe xhiron vjetore që ato realizojnë, sipas segmentit të nivelit të xhiros së secilës prej tyre kuptojmë se sa është mundësia potenciale për të llogaritur edhe tarifën potenciale për përdorimin e të drejtës së autorit, pa dëmtuar lirinë e biznesit të tyre dhe për të llogaritur një nivel tarife të pranueshme dhe të arkëtueshme me kosto sa më të vogël administrative.

**REGJISTRI I TATIMPAGUESVE, SIPAS NOMENKLATURAES SE VEPRIMTARIVE EKONOMIKE**
*mIn. Leke*

Nr.	Kodi		Pershkrimi	Mikro 0 - 5 milion	I Vogel 5 - 8 milion	I Mesem 8 - 180 milion	I Madh mbi 180 milion	Gjithsej
	nga	deri						
1	0100	0499	SEKSIONI A: BUJQESIA, GJUETIA DHE SILVIKULTURA	1,101	13	77	4	1,195
2	0500	0999	SEKSIONI B: PESHKIMI	978	4	22	0	1,004
3	1000	1299	NENSEKSIONI CA: NXJERRJA E PRODUKTEVE ENERJITIKE	108	4	27	8	147
4	1300	1499	NENSEKSIONI CB: NXJERRJA E PRODUKTEVE JO ENERJITIKE	345	8	125	7	485
5	1500	1699	NENSEKSIONI DA: INDUSTRIA E PRODUKTEVE BUJQESORE DHE USHQIMORE	3,517	45	165	29	3,756
6	1700	1899	NENSEKSIONI DB: INDUSTRIA TEKSTILE DHE E VESHJEVE	480	13	167	1	661
7	1900	1999	NENSEKSIONI DC: INDUSTRIA E LEKURES DHE E KEPUCEVE	63	2	54	6	125
8	2000	2099	NENSEKSIONI DD: PUNIMET ME DRU DHE FABRIKIMI I ARTIKUJVE PREJ DRURI	843	11	64	0	918
9	2100	2299	NENSEKSIONI DE: FABRIKIMI I BRUMIT TE LETRES, I LETRES DHE ARTIKUJVE PREJ	495	29	112	6	642
10	2300	2399	NENSEKSIONI DF: RAFINIMI I NAFTES, KOKSIFIKIMI, INDUSTRIA NUKLEARE	8	1	2	0	11
11	2400	2499	NENSEKSIONI DG: INDUSTRIA KIMIKE	102	12	65	7	186
12	2500	2599	NENSEKSIONI DH: INDUSTRIA E KAUCUKUT DHE E PALSTIKES	105	10	27	0	142
13	2600	2699	NENSEKSIONI DI: FABRIKIMI I ARTIKUJVE TE TJERA MINERALE JO METALIKE	475	20	141	32	668
14	2700	2899	NENSEKSIONI DJ: METALURGJIA DHE PUNIMI I METALEVE	1,030	21	116	14	1,181
15	2900	2999	NENSEKSIONI DK: FABRIKIMI I MAKINAVE DHE PAJISJEVE	52	4	20	0	76
16	3000	3399	NENSEKSIONI DL: FABRIKIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE	66	5	24	3	98
17	3400	3599	NENSEKSIONI DH: FABRIKIMI I MJETEVE TE TRANSPORTIT	40	1	7	0	48
18	3600	3999	NENSEKSIONI DN: INDUSTRI TE TJERA PERPUNUESE	1,033	31	86	6	1,156
19	4000	4499	SEKSIONI E: PRODHIMI DHE SHPERNDARJA E ENERGIJE ELEKTRIKE, E GAZIT DHE E UJIT	326	13	79	11	429
20	4500	4999	SEKSIONI F: NDERTIMI	3,678	202	1,421	194	5,495
21	5000	5499	SEKSIONI G: TREGETIA ME SHUMICE DHE PAKICE. RIPARIMI I AUTOMOBILEVE DHE I PAJISJEVE SHTEPI.	49,578	722	3,902	350	54,552
22	5500	5999	SEKSIONI H: HOTELET DHE RESTORANTET	18,899	102	234	11	19,246
23	6000	6499	SEKSIONI I : TRANSPORTET , DHE KOMUNIKACIONI	10,396	71	388	49	10,904
24	6500	6999	SEKSIONI J: NDERMJETESIMI FINANCIAR	710	23	46	32	811
25	7000	7499	SEKSIONI K: PASURITE E PATUNDESHME, DHENIA ME QIRA, DHE SHEBIMET KUNDREJT NDERRMARJEVE	7,663	161	479	46	8,349
26	7500	7999	SEKSIONI L: ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES; SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	1,971	26	100	3	2,100
27	8000	8499	SEKSIONI M: ARSIMI	811	26	56	5	898
28	8500	8999	SEKSIONI N: SHENDETI DHE VEPRIMTARITE SOCIALE	2,400	18	34	2	2,454
29	9000	9499	SEKSIONI O : AKTIVITETE TE TJERA TE SHERBIMIT KOLEKTIV , SIGURIMI SHOQEROR I DETYRUAR	8,397	44	199	18	8,658
30	9500	9899	SEKSIONI P: SHERBIMI SHTEPIAK	97	0	1	0	98
31	9900	9999	SEKSIONI Q: AKTIVITETE TE ORGANIZMAVE NDERKOMBETARE	114	0	6	0	120
32	0	0	AKTIVITETE TE TJERA*	90	1	1	0	92
Numri I tatimpaguesve sipas Regjistrimit Kombetar te Tatimpaguesve				115,971	1,643	8,247	844	126,705

*Sherim. Ne segmentin (0-5) regjistohen gjithë ata që nuk janë te grupet e tjera*

*\* Ne grupin e 32. perfshihen gjithë kodet ekonomike që nuk mund te regjistohen ne te tjera, per shkak gabime regjistrimi, moskodifikim etj. Nga QKR*

Me qëllim që të dhënat sa më lart të analizohen në një shpërndarje më të plotë, nga tabela më poshtë janë prezantuar pas përpunimeve të kryera të të dhënave edhe numrin e bizneseve, sipas rajoneve të vendit.

Kjo e dhënë si më poshtë shërben për një shpërndarje të barrës së tarifave jo vetëm brenda qendrave të mëdha urbane, por në të gjithë vendin. Qëllimi i kësaj shpërndarje është për të realizuar një tarifë që bazohet mbi parimin e barazisë përpara ligjit, për të zgjeruar bazën e llogaritjes në funksion të vlerës së pagesës, por edhe për edukimin e përdoruesve që nëpërmjet pagesës bëhen më mirëkuptuesë më detyrimet e tyre për të drejtën e autorit.



Numri bizneseve sipas rajoneve, 2022							
Rajonet	Gjithsej biznese	Prodhuesit dhe Ndertuesit	Tregtia	Transporti dhe magazinimi	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Informacioni dhe komunikacioni	Shërbime të tjera
Berat	4,027	3,411	1,712	218	704	61	716
Dibër	2,207	1,782	856	114	361	34	417
Durrës	12,721	10,544	4,813	738	1,574	287	3,132
Elbasan	7,673	6,541	2,921	480	1,363	151	1,626
Fier	9,564	8,143	4,262	460	1,453	136	1,832
Gjirokastrë	2,515	2,127	905	175	474	42	531
Korçë	6,167	5,343	2,484	440	1,088	110	1,221
Kukës	1,342	1,146	448	90	264	25	319
Lezhë	4,281	3,619	1,622	197	792	62	946
Shkodër	6,315	5,494	2,490	214	1,108	187	1,495
Tiranë	58,828	52,016	18,314	2,389	6,093	3,608	21,612
Vlorë	9,582	8,114	3,058	531	2,178	169	2,178
<b>TOTAL</b>	<b>125,222</b>	<b>108,280</b>	<b>43,885</b>	<b>6,046</b>	<b>17,452</b>	<b>4,872</b>	<b>36,025</b>
Burimi: INSTAT, DPT							

### Model tarifimi për përdorimin e të drejtave të autorit

Vlera ekonomike e tarifës qëndron në përfitimet dhe vlerat që mund të krijojë, si të prekshme, ashtu edhe të paprekshme. Për përcaktimin e tyre është e nevojshme të kryhet një analizë e kosto-përfitimit dhe e rrjedhës së parasë për qëllime të qëndrueshmërisë financiare, ekonomike dhe sociale, duke përcaktuar pikën e ndarjes midis vlerës së mbrojtur, koston se lidhur me ciklin e jetesës dhe shkallën e kënaqësisë së përdoruesit.

Ne llogaritjen dhe përcaktimin e tarifave të prejardhura nga përdorimi i të drejtës së veprës së autorit, sipas grupeve të bizneseve të vendosura do të mbahen parasysh edhe parimet në drejtim të:

- (a) Balancimit në treg: Tarifatat duhet të balancohen në mes standardeve minimale të shërbimeve, qëndrueshmërisë financiare të Ofruesve të Shërbimeve dhe mundësisë paguese të Konsumatorit;
- (b) Ndikimit të pandjeshëm të Kostot: Tarifatat duhet të jenë të arsyeshme dhe të lidhura ngushtë me burimet financiare të ofruesit të shërbimeve apo mallrave, me kusht të operimit eficient i tyre, të mbulojë edhe vlerën e tarifës pa ndikuar në përditshmërinë e biznesit dhe një çmimi të paarsyeshëm për konsumatorin duke marrë shkas nga kjo tarifë;
- (c) Qasja e Barazisë Konsumatore (Përdoruesi Pagan): Çdo konsumator duhet të faturohet me me çmimin e duhur dhe e tillë që të mos ndikojë të pagesa e tij në kohë dhe e plotë;
- (d) Drejtësisë Sociale: Struktura tarifore duhet të reflektojë drejtësinë dhe korrektësinë në raport proporcional me shërbimin dhe tvendosjen e çmimeve.
- (e) Performancës së Ofruesit të Shërbimeve: Ofruesit e Shërbimeve nuk duhet të kenë kompensim përmes tarifave për performancën joefikase dhe joeficiente të detyrave të tyre.

Ofruesit e Shërbimeve që përdorin pronësinë artistike të autorëve duhet të paguajnë tarifa të njëjta të shërbimit për tërë zonën e shërbimit për llojin e njëjtë të Shërbimeve .

Pak studime të vlerësimit ekonomik janë ndërmarrë në fushën e të drejtës së autorit dhe tarifës së duhur që duhet lidhur me cmimin e shërbimit. Të gjitha studimet e rishikuara përdorin metodat e preferencës, kryesisht vlerësimin e kushtëzuar. Ekzistojnë shumë pak aplikime të metodave të zbuluara të preferencës.

Rëndësia e tarifës qëndron në përfitimet ose vlerat që ajo gjeneron. Ato mund të përfshijnë:

- përfitimet financiare
- cilësitë estetike
- imazh të përmirësuar të komunitetit
- mundësitë për rigjenerimin e fondeve që mbliidhen për të gjallëruar jetën artistike dhe kulturore.

Një analizë kosto-përfitim e opsioneve të politikave për mbrojtjen dhe maksimalizimin e vlerës së tarifës kërkon që kostot dhe përfitimet të mund të identifikohen dhe kuantifikohen, duke konsideruar, natyrën specifike të shumë prej përfitimeve që lidhen me përdorimin e veprave në brendinë dhe thelbin e aktiviteve. Si rezultat, ato nuk mund të vlerësohen duke përdorur teknikat normale të vlerësimit (çmimit) të tregut. Në përgjigje të kësaj dileme të ngjashme me tregun për shërbimet mjedisore, ekonomistët kanë zhvilluar vlerësimin e bazuar mbi teknika jo tregtare, për të kuantifikuar ato të mira kulturore, që ekzistojnë jashtë tregut privat.

Analiza e koston dhe përfitimit në rastin e opsioneve të vendimmarrjes për tarifën e të drejtës së autorit kërkon jo vetëm kuantifikimin e përfitimeve jo-materiale, por edhe konsiderimin e kostove të përdoruesve të të drejtës së autorit.

Tarifat nuk mund të përdoren si një metodë për të kontrolluar rritjen e përdorimit të të drejtës së autorit, por për të patur një ndikim të pandjeshëm në këtë drejtim.

Tarifat sipas metodologjisë që parashikon si bazë llogaritje përdorimin e të drejtës së autorit mbi veprat e tyre do të duhet të paguhen vetëm nëse përfitohet nga to një vlerë e shtuar për përdoruesit, e bërë transparente nëpërmjet të dhënave ekonomike dhe që janë të verifikueshme në kohën që janë objekt diskutimi.

Vlerësimi ekonomik i tarifës synon të sigurojë një shprehje monetare të të drejtës së autorit.

Duhet të theksohet se përdoruesit e të drejtës së autorit zakonisht nuk janë vetëm në lidhje me vlerën e përdorimit të drejtpërdrejtë (të tillë si në formën e të ardhurave nga turizmi), por gjithashtu lidhen me efekt më të gjerë të përfshira që kanë ndërthurje me urbanizimin e ambjentit dhe nivelin dhe mënyrën e organizimit të ekonomisë së vogël dhe rajonale.

**METODOLOGJIA DHE MASA E TARIFAVE TË SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË  
MBROJTURA NGA E DREJTA E AUTORIT  
NË SISTEMIN E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV**

**PJESA I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**KREU I**

**E DREJTA E AUTORIT DHE TË DREJTAT E TJERA TË LIDHURA ME TO**

E drejta e autorit mbron krijimet origjinale intelektuale letrare, artistike dhe shkencore të gjitha llojeve të autorëve, ku vepra e autorit mbart karakteristika individuale, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së saj, objektivi dhe rëndësia, për aq sa nuk parashikohet ndryshe në ligjin 35/2016, i ndryshuar (në vijim LDA). LDA i jep autorit të një vepre një grup të drejtash ekskluzive mbi veprën e tij, të cilat i mundësojnë atij të kontrollojë përdorimin e punës së tij në një sërë mënyrash dhe të marrë shpërblim.

E drejta e autorit mund të ekzistojë në çdo vepër letrare ose vepër arti ose shkencore e profesionale, të shprehur në çfarëdo forme, veçanërisht tekste të shkruara ose të folura, kompozime muzikore, me ose pa tekst, vepra teatrale, me ose pa muzikë, koreografi dhe pantomime, vepra audio-vizuale, vepra të arteve pamore, duke përfshirë vizatimet, pikturat dhe skulpturat, gdhendjet dhe litografitë, veprat arkitekturore, pikturat, fotografitë, veprat e artit të aplikuar, ilustrimet, hartat, veprat tredimensionale të artit që lidhen me gjeografinë, topografinë, arkitekturën ose shkencën.

Përveç kësaj, mbrohen: përkthimet, përshtatjet, rregullimet dhe ndryshimet e tjera të veprave ose shprehjeve të traditës popullore; dhe koleksione veprash ose koleksione shprehjesh të traditës popullore ose faktesh e figurash të thjeshta, si enciklopedi dhe antologji.

Më poshtë renditen veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit:

- a) krijimet e fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare dhe publicistike, leksionet, predikimet fetare, fjalimet, çdo krijim tjetër me gojë ose me shkrim dhe programet kompjuterike;
- b) krijimet dramatike dhe dramatiko-muzikore;
- c) kompozimet muzikore, me ose pa tekst;
- ç) krijimet koreografike dhe pantomimat;
- d) krijimet audiovizuale, në të cilat përfshihen krijimet kinematografike dhe krijimet e tjera audiovizuale të krijuara në mënyra të ngjashme me ato kinematografike, veprat radiofonike;
- dh) krijimet e artit pamor në fushën e pikturës, skulpturës dhe grafikës, artet dekorative monumentale, pavarësisht nga materiali/mediumi përbërës i tyre, dhe krijime të tjera të artit pamor;
- e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore;
- ë) krijimet fotografike dhe çdo krijim tjetër që shprehet nga çdo proces i ngjashëm me atë fotografik;
- f) veprat e arteve të aplikuara, duke përjashtuar ato vepra, si dizajne industriale që mbrohen nga ligji “Për pronësinë industriale”;

- g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi;
- gj) krijimet hartografike;
- h) krijimet shkencore me shkrim ose me gojë, siç mund të jenë prezantimet, monografitë, deduksionet, disertacionet, studimet, leksionet universitare, librat shkollorë, projektet dhe dokumentacioni shkencor.

## **KREU 2 PËRKUFIZIME**

*“Abonim”* nënkuptohet kontrata e shërbimit, lidhur midis ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizive (OSHMA) me pagesë dhe marrësit të këtyre shërbimeve.

*“Agjenci e Administrimit Kolektiv (AAK)”* nënkupton subjektin juridik, të krijuar më parë nga mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to dhe e licencuar nga Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit si agjenci me objekt të veprimtarisë së saj administrimit e një, dy ose më shumë kategori të drejtash, me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga përdorimi i veprave për të cilat janë autorizuar nga mbajtësit e këtyre të drejtave dhe shpërndarjen e tyre tek anëtarët e tyre, mbajtës të së drejtave, duke mbajtur detyrimet tatimore, si agjent tatimor sipas parashikimeve ligjore.

*“Destinacion turistik”* nënkupton pikën turistike me një përqendrim të lartë të produkteve turistike, i ngritur mbi bazën e studimeve dhe planeve të zonës dhe që ka kapacitete për të tërhequr vizitorë, vendës e të huaj, duke plotësuar e kënaqur kërkesat e tyre.

*“Kohëzgjatje”* nënkupton raportin e shprehur në përqindje të kohës së përdorimit të veprës së mbrojtur nga sporteli unik/AAK-të në programacionin ditor (24 orë) nga subjekti përdorues.

*“Komunikimi në publik i një vepre të mbrojtur nga e drejta e autorit”* nënkuptohet sipas përmbajtjes së nenit 29 të ligjit 35/2016

*“Ofrues shërbimi mediatik audioviziv (OSHMA)”* është personi fizik ose juridik që ka përgjegjësinë editoriale për zgjedhjen e përmbajtjes së shërbimeve të transmetimit audioviziv dhe që vendos mënyrën e organizimit të saj.

*“Origjinalitet”*, një koncept i papërcaktuar nga ligji, është konkluzioni se, në rrethana të ngjashme dhe me të njëjtat objektiva, asnjë krijues/autor tjetër nuk do të ishte në gjendje të krijonte një vepër të natyrës së ngjashme. Prandaj, individualiteti i secilës vepër luan një rol jetik dhe pasqyron specifikën e procesit krijues të krijuesit të saj, kështu që vepra zotëron një "unikalitet".

*“Programacion”* nënkupton aktivitetet dhe programet e ndryshme ditore që përdorin operatorët transmetues dhe ritransmetues (OSHMA).

*“Program radio”* nënkuptohet tërësia e mesazheve audio që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit radio.

*“Program televiziv”* nënkuptohet tërësia e imazheve lëvizëse, me ose pa zë, që përbëjnë një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, forma dhe përmbajtja e të cilit janë të krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filma, ngjarje sportive, komedi, dokumentarë, programe për fëmijë dhe drama origjinale.

*“Sporteli unik”* nënkuptohet agjencia që kryen funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga subjektet përdoruese, në emër të agjencive të licencuara, për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave objekt përfaqësimi, që krijohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet agjencive të licencuara të administrimit kolektiv ose sipas rastit me anë të vendimmarrjes së KKDA-së.

*“Strukturë akomoduese”* nënkuptohet struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendës apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj.

*“Subjekti përdorues”* nënkupton çdo operator që kryen veprimtari fitimprurëse ose jo në territorin e Republikës së Shqipërisë, i cili konsumon/shfrytëzon vepra të mbrojtura nga ligji i të drejtës së autorit objekt përfaqësimi nga sporteli unik/AAK-të.

*“Të ardhura bruto”* nënkupton të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit të deklaruar në pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të përdoruesit. Nuk përfshihen në të ardhurat bruto në rastin e transmetimeve radiotelevizive:

- Shumat e arkëtuara për prodhimin e një programi radioteleviziv të porositur nga një person fizik apo juridik dhe që në fund bëhet pronë e tij;
- Rimarrjen e çdo shume të paguar për të marrë të drejtat ekskluzive kombëtare ose lokale të transmetimit të një ngjarje sportive, nëse stacioni radioteleviziv mund të vërtetojë se ka paguar edhe tarifën normale për kohën dhe pajisjet e stacionit.

*“Tarifë fikse”* nënkuptohet përmbajtja e nenit 149 të ligjit 35/2016, i ndryshuar.

*“Vepër e mbrojtur nga e drejta e autorit”* është çdo krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, i cili mbart karakteristika individuale, pavarësisht nga mënyra ose forma e shprehjes së tyre, objektivi, rëndësia, për aq sa nuk parashikohet ndryshe dhe sipas referencave të nenit 8 të ligjit 35/2016, i ndryshuar.

*“Zbatimi dhe mbulimi nga metodologjia”* nënkuptohet sipas përmbajtjes së nenit 2 të Ligjit 35/2016, i ndryshuar.

### **KREU 3**

#### **KONTRIBUTI I INDUSTRIVE TË BAZUARA NË TË DREJTAT E AUTORIT**

Kontributi i industrive të bazuara në të drejtën e autorit mund të sigurohet nga pjesa e tyre në vlerën e shtuar bruto me çmimet bazë dhe pesha që mbajnë ato në produktin e brendshëm bruto (PBB) për periudhat sipas tabelës më poshtë.

### Shuma e arkëtimeve të të drejtës së autorit nga përdoruesit

000 lekë

AAK	Emërtimi	Viti			
		2019	2020	2021	2022
	Shuma e arkëtimeve	72,137.76	30,247.66	74,050.99	60,090.57
	Pesha në PBB (%) e bizneseve përdoruese të të drejtës së autorit	0.2%	0.1%	0.2%	0.1%

Burimi: SUADA

Kontributi ekonomik i industrive të bazuara në të drejtat e autorit në vitet 2019 - 2022 mund të prezantohet si më poshtë:

- Në vitin 2019, vlera bruto prej 36 miliardë Lekë është vlera e shtuar në prodhimin e brendshëm të vendit nga aktivitetet ekonomike të lidhura me të drejtat e autorit dhe të drejtat fqinje që kanë paguar tarifën sipas metodologjisë.
- Në vitin 2020, vlera bruto është më e ulët dhe arrin në një vlerë të shtuar prej 15.1 miliardë lekë, nisur nga bllokimi i aktiviteteve kryesore që lidhen me përdorimin e shpeshtë të të drejtës autoriale.
- Në vitin 2021, vlera bruto e shtuar është 37.2 miliard lekë dhe ky vit është periudhë që ka një rritje të arkëtimeve të të drejtës së autorit nga agjensitë e administrimit kolektiv dhe të raportuar nga SUADA (Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit).
- Në vitin 2022, vlera bruto e shtuar është 30 miliard lekë duke regjistruar një rënie të lehtë të arkëtimeve, që lidhet më së shumti me një nevojë për zgjerimin e bazës së paguesve të të drejtës së autorit dhe në funksion të respektimit të zbatimit të ligjit.

Sipas të dhënave të vitit të fundit (2022) të prezantuara, industritë kryesore të së drejtës së autorit që dhanë kontributin më të madh ekonomik janë mediat audiovizuale, njësitë tregtare, njësitë e shërbimit dhe akomodimit, si dhe dhe aktivitete shërbimi direkte të lidhura me përdorimin e të drejtës së autorit në ambjente të ndryshme përdorimi.

Nr.	KATEGORIA E SUBJEKTIT	TE ARDHURAT	PERQINDJA E PAGESES SE SUBJEKTEVE*	PERQINDJA TE ARDHURAVE TOTALE*
1	OFRUES SHËRBIME TË MEDIAVE AUDIOVIZUALE	50,724,002	58.00%	83.70%
2	NJËSI TREGTARE	4,603,398	0.37%	7.60%
3	HOTELE	4,390,627	4.20%	7.20%
4	RESTORANTE/BAR /CAFFE	592,185	0.03%	1.00%
5	EVENTE	269,159	-	0.40%
	<b>TOTALI</b>	<b>60,579,371</b>		<b>100%</b>

Nga treguesit shihet se më shumë se gjysma e tarifës së të drejtës së autorit mbahet nga ofruesit e mediave audiovizuale dhe pas tyre janë njësitë tregtare, ku pjesa më e pandjeshme janë shërbimet e restoranteve dhe bar-kafeve dhe eventet direkte.

Pjesa e kontributit të industrive të bazuara në të drejtat e autorit zbulon një sektor të rëndësishëm, por të vogël të ekonomisë shqiptare deri më sot edhe pse në zgjerim. Ky është sektori multiindustrial i turizmit. Megjithatë, kjo metodologji nuk ka objekt të saj të japë një perspektivë të qartë të ritmeve të rritjes së industrive të bazuara në të drejtat e autorit, duhet theksuar se secila nga aktivitetet janë pjesë e sektorëve me zhvillim të shpejtë të ekonomisë.

Nga kërkimet në vendet e tjera fqinje me Shqipërinë lidhur me peshën që mbajnë në këto vende aktivitetet përdoruese të të drejtës së autorit shihet se kanë një afërsi edhe pse në këto vende ka një peshë më të lartë në PBB, që varion 0.6 – 1% të PBB-ë më shumë se në Shqipëri.

Analiza e faktorëve të realitetit ekonomik dhe e formave të administrimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave fqinje në tregun e lirë tregon se forma e administrimit të së drejtës së autorit ndikohet nga ndryshimet në mjedisin ekonomik.

Kjo mund të shihet në terma të rritjes reale në aktivitetet e organizatave të administrimit kolektiv për të drejtat e autorit dhe të drejtat fqinje, duke vepruar si një ndërmjetës ekonomik midis mbajtësve të të drejtave dhe përdoruesve, nëse përdorimi i tyre gjeneron të ardhura.

## **KREU 4**

### **BAZA LIGJORE DHE TË DHËNAT E PËRDORURA PËR METODOLOGJINË**

Për hartimin e Metodologjisë bazuar mbi gjithpërfshirjen e të dhënave dhe propozimeve nga agjensitë e administrimit kolektiv, ashtu si dhe Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, si dhe përdoruesit janë vendosur më poshtë referencat dhe të dhënat e përdorura, si:

- Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i ndryshuar.
- Vendimi nr. 3 datë 4.8.2017 “Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv.”
- Vendimi nr. 2 datë 22.6.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 3 datë 4.8.2017 Për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv.”
- Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale, 2022 - 2025
- Të dhëna statistikore për PBB-në, taksapaguesit dhe bizneset në Shqipëri.

- Qëndrimet dhe propozimet e agjensive të administrimit kolektiv dhe përdoruesve kryesorë<sup>8</sup> dhe drafti i propozimit të përbashkët të agjensive të administrimit kolektiv të përgatitur nga Sporteli unik<sup>9</sup>.

## KREU 5

### RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR METODOLOGJINË E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE

Rregullat të përgjithshme procedurale, që sigurojnë një rezultat të ligjshëm në përcaktimin e tarifave në çdo rast:

*Transparenca:* Të gjitha procedurat në lidhje me përcaktimin e tarifave duhet të zhvillohen në mënyrë transparente. Kjo përfshin ofrimin e aksesit në informacionin përkatës për të gjitha palët e përfshira.

*Përfshirja e palëve të interesuara:* Përfaqësuesit e autorëve, interpretuesve, producentëve dhe mbajtësve të tjerë të të drejtave, si dhe përdoruesit e veprave, duhet të përfshihen aktivisht në procesin e vendimmarrjes. Mendimet dhe sugjerimet e tyre duhet të merren parasysh siç duhet.

*Barazia dhe Drejtësia:* Procesi duhet të sigurojë që interesat e të gjitha palëve të jenë të balancuara. Tarifat duhet të jenë të drejta dhe të barabarta, duke reflektuar vlerën e të drejtave që administrohen.

*Konsultimi:* Para finalizimit të çdo tarife, duhet të ketë konsultim të plotë me të gjitha palët e prekura. Kjo përfshin dhënien e kohës së mjaftueshme për komente dhe shqyrtimin e të gjitha përgjigjeve me kujdes.

*Kriteret objektive:* Kriteret për vendosjen e tarifave duhet të jenë objektive, bazuar në faktorë të qartë dhe të justifikueshëm si natyra dhe shtrirja e përdorimit të punimeve.

*Rishikimi i rregullt:* Tarifat duhet të rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në modelet e përdorimit të tregut dhe kushtet ekonomike. Kjo siguron që ato të mbeten të drejta dhe relevante.

---

<sup>8</sup> ALBAUTOR, AKDIE, FMAA dhe FABER COLLECTIVE PHONOGRAM, OSHMA (RTL), TringTV/Vizion Plus, TCH, TV Klan, Club FM Radio, Vodafone OTT/IPTV, ONE Albania, BRC, BTSH, ATA, BTSH

